

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues përbërë prej gjyqtarës Raima Elezi, si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve Mehmet Ndrecaj dhe Bekri Vehapi, si anëtarë, me sekretaren juridike Valdete Zurnaxhiu, në lëndën penale kundër të akuzuarve: P. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale fajdeja nga neni 343 par. 1 të KP-së, E. Th., nga Prizreni dhe A. K., nga fshati G. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale të detyrimit nga neni 340 par. 2 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KP-së, E. Th. edhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KP-së, N. K. nga fshati V. Komuna e Prizrenit dhe Gj. K. nga fshati Sh. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale fajdeja nga neni 343 par. 1 lidhur me nenin 28 të KP-së, N. K. edhe për veprën penale të detyrimit nga neni 340 par. 2 KP-së, B. P. nga Prizreni për shkak të dy veprave penale fajdeja nga neni 343 par. 1 të KP-së dhe mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KP-së, E. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale detyrimi nga neni 340 par. 1 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr. 196/14 të datës 25.02.2015 dhe të ndryshuar në fjalën përfundimtare me datën 10.01.2018, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në praninë e Prokurorit të Shtetit Genc Nixha, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av. V. O., av. P. P., av. B. N., av. S. M., av. B. S., av. Sh. B., përfaqësuesit të autorizuar për të dëmtuarit av. R. T., me datë 16.01.2018 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

P. M. nga i ati M. dhe e ëma P. e lindur D., i lindur me datë *data e lindjes* ... në fshatin G. Komuna e Prizrenit, jeton në Prizren rr... nr. ..., ka të kryer kate vite të shkollës fillore, i martuar baba i një fëmije, bujk, punon në fermën e vet në fshatin G. ..., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. Personal *numri personal*..., më herët i dënuar, në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 14.07.2014 deri më datën 06.11.2014.

E. TH. nga i ati P. dhe e ëma M. e lindur K., i lindur me datë *data e lindjes*... në Prizren , ku edhe tani jeton Rr. ... nr..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar babai i një fëmiju, me profesion kuzhinier, i papunë, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal *numri personal*..., më parë i dënuar, në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 14.07.2014 deri më datën 26.11.2014..

A. K. nga i ati V. dhe e ëma H. e lindur G. i lindur me datë *data e lindjes*... në fshatin G. Komuna e Prizrenit, ku edhe jeton, ka të kryer fakultetin e infermierisë, më herët i punësuar në Spitalin Rrajonal “Daut Mustafa”, tani i martuar baba i dy fëmijëve, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal *numri personal*... , më herët i padënuar .

N. K. nga i ati N. dhe e ëma M. e lindur B. i lindur me datë *data e lindjes*... në Prizren, me vendbanim në fshatin V. Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën fillore, tregtar – shitblerja e veturave, i pamartuar, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal *numri personal*..., më parë i dënuar, në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 14.07.2014 deri më datën 10.12.2014.

B. P. nga i ati L. dhe e ëma R. e lindur P., i lindur me datë *data e lindjes...* në Prizren, ku edhe tani jeton rr. ... nr..., ka të kryer shkollën fillore, bujk, pronar i lokalit “R.” i martuar baba i katër fëmijëve, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike, gjendet në paraburgim për shakë të veprës penale të vrasjes , në arrest shtëpiak prej datës 16.09.2014 deri më datën 16.10.2014.

GJ. K. nga i ati L. dhe e ëma M. e lindur Th. i lindur me datë *data e lindes...* në fshatin Sh. Komuna e Prizrenit ku edhe tani jeton , studentë i vitit të IV të Kolegjit “Fama”, i punësuar në Prizren në firmën “P. H.”, i martuar baba i një fëmiu, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. Personal *numri personal...*

E. M. nga i ati P. dhe ëma P., e lindur G., i lindur me datën *data e lindjes...* në Prizren, me banim në rr. ... nr. ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i tre fëmijëve, bujkë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal *numri personal...*, i padënuar.

I.

JANË FAJTORË

I. I akuzuari P. M.

se me qëllim që vetes ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, në këmbim të shërbimit për personin tjetër, duke e shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të të dëmtuarit I. K. nga Prizreni, gjatë vitit 2010 në kohë saktësisht të pavërtetuar ia jep borxh shumë prej 2.000 €, me interes prej 15% për të mjekuar të bijën e tij, ashtu që nga i ati i të dëmtuarit S. K. nga Prizreni, në muajin shtator të vitit 2013 kërkon dhe merr shumë prej 5.300 € në të cilën shumë llogaritet borxhi kryesor dhe kamata, me këtë veprim të dëmtuarve në emër të fajdesë u shkakton dëm prej 5.300 €.

Kësodore ka kryer veprën penale fajdeja nga neni 343 par.1 të KP-së.

II. Të akuzuarit E. Th. dhe A. K..

se si bashkëkryesit me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i sjellin përfitim të kundërligjshëm të dobisë pasurore përdorin kanosjen serioze për t'i detyruar të dëmtuarit S. dhe I. K. nga Prizreni që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre, në atë mënyrë që pasi bëjnë disa shitblerje të automjeteve me të dëmtuarin I. K. gjatë vitit 2013, duke i blerë me çmime të ulëta, ndërsa ia kanë shitur me çmime më të larta se sa shiteshin në tregun e lirë, me datën 24.02.2014 të akuzuarit shkojnë në shtëpinë e të dëmtuarve në Prizren, në rr.... nr. ..., marrin për obligim që të dëmtuarit I. K. t'ia mbulojnë të gjitha borxhet që kinse ia kishte një personi nga Gjakova dhe njërit nga Peja, emrat e të cilëve nuk përmenden, ashtu që dy herë kanë shkuar në lokalit e tij, herën e parë ia kanë dërguar 20.000 € e herën e dytë 25.000 €, të cilat para i kanë nxjerrë nga xhepi, ashtu që shuma totale ka qenë 45.000 € dhe ia kanë lënë në tavolinë pastaj të njëjtat i marrin dhe këto të holla ia japin në dorë B. P., pastaj me datën 25.04.2014 të akuzuarit shkojnë në shtëpinë e të dëmtuarve duke u kërcënuar atyre që të pranojnë se kinse me datën 12.02.2014, 20.02.2014 dhe 25.02.2014 të dëmtuarit të kenë marrë nga të akuzuarit tri herë nga 50.000 €, i detyrojnë të dëmtuarit që të nënshkruajnë një marrëveshje të shkruar të përgatitur më parë në gjuhën shqipe, përmbajtjen e të cilës i dëmtuari S. K. nuk ka kuptuar fare, meqenëse nuk komunikon në gjuhën shqipe por fletë vetëm gjuhën turqishte përmes kësaj marrëveshje detyrohen të dëmtuarit që me datën 25.04.2014 nëse nuk i paguajnë 150.000 €, në emër të këtij borxhit, shtëpinë do të bartin në

emër të të akuzuarit E. Th. pasi shtëpia të lirohet nga hipoteka, e gjatë muajit qershor dhe pjesës së parë të muajit korrik të vitit 2014 i akuzuari E. Th. shkon më se 40 herë ndërsa i akuzuari A. K. më se 20 herë në shtëpinë e të dëmtuarve duke u kërcënuar që ta shesin shtëpinë, se do të vrasin tërë familjen, si dhe djalin e vogël të cilin e kishin në djep, i akuzuari E. Th. është kërcënuar me pistoletë ndërsa i akuzuari A. K. nuk ka pasur armë, ashtu që me veprimet e tyre kanë shkaktuar shqetësim të thellë tek të dëmtuarit dhe anëtarët e familjes së tyre deri sa rastin e kanë paraqitur pranë policisë Regjionale në Prizren, kur me datën 14.07.2014 janë arrestuar .

-me këtë si bashkëkryerës kanë kryer veprën penale detyrimi nga neni 340 par.2 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KP-së.

III I akuzuari E. Th.

se ka mbajtur në pronësi armën në shkelje me ligjin e zbatueshëm, në atë mënyrë që nga data e pavërtetuar deri më datën 14.07.2014 në automjetin “Kia FA” , me targa të regjistrimit *numri i targës...* ka poseduar një pistoletë “P Bereta” kalibrit 7,65mm, nr, V 730691, prodhuar në Itali, një karikator dhe dy fishekë, ndërsa në veturën “VW”, me targa *numri i targës...* ka poseduar një pushkë gjysme automatike, me nr. 229956, të cilat automjete kanë qenë të parkuar në afërsi të shtëpisë së tij në Prizren në rrugën M. K., të cilat i ka poseduar pa leje të Organit kompetent dhe të cilat janë konfiskuar me rastin e bastisjes nga ana e policisë.

-me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KP-së.

IV. I akuzuari N. K.

gjatë vitit 2013 në Prizren në kohë të pavërtetuar, në emër të vetë negocion haptas përfitim jo proporcional për shërbim që ia kryen të dëmtuarit I. K. nga Prizreni, të cilit ja jep borxh 2.500 € me kamat mujore prej 20 % ashtu që nga babai i të dëmtuarit S. K. gjatë muajit mars të vitit 2014 kërkon dhe merr shumën prej 6.700 €, ku llogaritet borxhi kryesor prej 2.500 € si dhe fajdeja 4.200 €.

-me këtë ka kryer veprën penale fajdeja nga neni 343 par. 1 KP-së

VI. I akuzuari B. P..

se me qëllim që vetes t’i siguroj dobi të kundërligjshme jo proporcionale, në këmbim të shërbimit për personin tjetër, duke e shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të të dëmtuarit B. M., nga fshati L. Komuna e Prizrenit, me datën 10.12.2012 në Prizren, në një kafiteri e cila gjendet tek qafa e kishës negocion me të dëmtuarin B. M. ashtu që atij ja jep 1.150 € ku harton një procesverbal se kinse i dëmtuari i ka marr nga ai 4.000 €, ndërsa pas katër muajve e detyron të dëmtuarin që t’ia paguajë shumën prej 4.400 €.

-me këtë ka kryer veprën penale fajdeja nga neni 343 par. 1 të KP-së.

VII. I akuzuari B. P..

gjatë muajit tetor të vitit 2013, në kohë të pavërtetuar në emër të vetë negocion haptas përfitim jo proporcional për shërbim që ia kryen personit tjetër duke e shfrytëzuar gjendjen e tij të rëndë financiare, në atë mënyrë që të dëmtuarit I. K. nga Prizreni ia jep borxh shumën

prej 5.000 € me kamatën mujore prej 20 % ashtu që në muajin shkurt të vitit 2014 e thërret babanë tij S. K. dhe e porosit që të shkojë në shtëpinë e tij dhe parat në shumë prej 7.000 € t'ia dorëzojë bashkëshortes së tij i cili edhe ka vepruar sipas porosisë,

-me këtë ka kryer veprën penale fajdeja nga neni 343 par. 1 të KP-së.

VIII. I akuzuari B. P.

se ka mbajtur në pronësi armën me shkeljen e ligjit të zbatueshëm, në atë mënyrë që nga data e pavërtetuar deri më datën 14.07.2014, në shtëpinë e tij në Prizren në rr. ..., në katin e parë të shtëpisë ka mbajtur pa leje të organit kompetent pistoletën e tipit M 57 , të kalibrit 7.62mm , me nr. serik C 45291, me një karikator dhe 8 copë fishekë të cilat janë konfiskuar nga policia me rastin e bastisjes.

-me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KP-së.

II.

Në bazë të nenit 363 par. 1 nënpar. 1.1 të KPP-së

REFUZOHET AKUZA

ndaj të akuzuarit Gj. K.

se si bashkëkryerës, me qëllim që vetes t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm të dobisë pasurore, me datën 10.07.2014, me të akuzuarin N. K. shkon në shtëpinë e të dëmtuarit S. K. në Prizren, e cila gjendet në rr. ... nr. .., kërkojnë nga i dëmtuari që tua paguajë shumën 41.300 € në emër të borxhit që kishte marrë I. K., i biri i të dëmtuarit S. K., duke e kërcënuar se nëse ky borxh nuk paguhet brenda datës 10.07.2014, në këtë shumë do të llogaritet edhe kamata.

-me këtë do të kishte kryer veprën penale fajdeja nga neni 343 par. 2 në bashkëkryerje lidhur me nenin 31 të KP-së.

-sepse Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare është tërhequr nga akuza.

III.

Në bazë të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPP

LIROHEN NGA AKUZA

IV. I akuzuari N. K..

me qëllim që vetes t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm të dobisë pasurore, me datën 10.07.2014, shkon në shtëpinë e të dëmtuarit S. K. në Prizren, e cila gjendet në rr. .. nr. .. dhe me kërcënim serioz kërkon dhe detyron të dëmtuarin që t'ia pagujë shuma 41.300 €, në emër të borxhit që kishte marrë djali i tij, I. K., nga N. P. dhe duke e detyruar dhe obliguar që ky borxh të paguhet dhe kërcënohet se nëse nuk paguhet, në këtë shumë do të llogaritet edhe kamata.

-me këtë ka do të kishte kryer veprën penale të detyrimit nga neni 340 par. 2 të KP-së.

X. I akuzuari E. M.

se me qëllim që vetes dhe për personin tjetër të sjellë përfitim të kundërligjshëm financiar duke përdorur kanosje, në rastin konkret nga i dëmtuari I. K. për borxhin në shumë prej 2.000€, të cilin i njëjti e kishte marr nga babai i tij P. M., ashtu që e detyron të dëmtuarin që të veprojë në dëm të pasurisë së tij duke kërkuar dhe nxjerrë nga ai para në shumë prej 4.600 € si dhe duke e detyruar më parë që babai i tij S. K. ta dorëzojë shumën e përgjithshme prej 2.300 €, që gjithsejte shuma del 6.900 €,

-me këtë do të kishte kryer veprën penale detyrimi nga neni 340 par. 1 të KP-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 69, 73, 74, 76, 80, 83, dhe neneve të përmendura më lartë KP-së i

G J Y K O N

-të akuzuarin **P. M.**, për veprën penale nën I/ të dispozitivit me dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) € dhe me dënim me burg në kohë zgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, në të cilën dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 14.07.2014 deri më datën 06.11.2014 ;

-të akuzuarin **E. Th.**, për veprën penale nën II/ të dispozitivit me dënim me gjobë në shumë prej 2.000 (dymijë) € dhe me dënim me burg në kohë zgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilën dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 14.07.2014 deri më datën 26.11.2014, për veprën penale nën III/ të dispozitivit me dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) €, ashtu që gjykata e gjykon me dënim unik me gjobë në shumë prej 3.000 (tremijë) €;

-të akuzuarin **A. K.** për veprën penale nën II/ të dispozitivit me dënim me gjobë në shumë prej 2.000 (dymijë) € dhe me dënim me burg në kohë zgjatje prej 6 (gjashtë) muaj;

-të akuzuarin **N. K.** , për veprën penale nën IV/1 të dispozitivit me dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) € dhe me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, në të cilën dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 14.07.2014 deri më datën 10.12.2014;

-të akuzuarin **B. P.** , për veprën penale nën VI/ të dispozitivit me dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) € dhe me dënim me burg në kohë zgjatje prej 1 (një) vite, për veprën penale nën V/1 me dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) € dhe me dënim me burg në kohë zgjatje prej 1 (një) viti , për veprën penale nën V/3 të dispozitivit me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, ashtu që gjykata e gjykon me dënim unik me gjobë në shumë prej 2.300 (dymijetreqind) € dhe me dënim unik me burgim në kohë zgjatje prej 1 (një) vjet dhe 8 (tetë) muaj në të cilën dënim llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 16.09.2014 deri me datën 16.10.2014.

Nëse të akuzuarit P. M., E. Th., A. K., N. K. dhe B. P. nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë dënimin me gjobë gjykata do të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg ashtu për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktojë një ditë burg, të gjithua këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarit B. M., I. K. dhe S. K., për realizimin e kërkesës pronësoro juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Prej të akuzuarit E. Th. konfiskohen: një pistoletë e tipit “P. Bereta” me nr. serik V 730691, kalibër 7,65 mm, një karikatorë dhe dy fishekë të pistoletës me mbishkrim në bazë “S&B7.65 Br” dhe një pushkë gjysmë automatike me nr. serik 229956, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Prej të akuzuarit B. P. konfiskohet një pistoletë M 57, kalibri 7,62 mm, me nr. serik “C45291” një karikator dhe 8 fishekë, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohen të akuzuarit P. M., E. Th., A. K., N. K. dhe B. P. të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës e në emër të paushallit gjyqësor shumë në prej nga 400 €, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës penale sa i përket të akuzuarve Gj. K. dhe E. M., bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.nr.196/2014 të datës 25.02.2015, kundër të akuzuarve: P. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale fajdeja nga neni 343 par.1 të KP-së, E. Th. nga Prizreni dhe A. K. nga fshati G. Komuna erizrenit, për shkak të veprës penale detyrimi në tentativë nga neni 340 par. 2 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KP-së, E. Th. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KP-së, N. K. nga fshati V. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale fajdeje nga neni 343 par. 1 të KP-së, N. K. dhe Gj. K. për shkak të veprës penale fajdeja në tentativë nga neni 343 par. 2 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KP-së, B. P. nga Prizreni për shkak të dy veprave penale fajdeja nga neni 343 par. 1 të KP-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KP-së, L. P. nga fshati V. Komuna e Prizrenit dhe Gj. K. nga fshati Sh. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale fajdeja nga neni 343 par. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së, F. S.1 dhe F. S.2 të dytë nga Prizreni, për shkak të veprës penale detyrimi nga neni 340 par. 2 lidhur me nenin 31 të KP-së, F. S.1 edhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KP-së dhe E. M. nga Prizreni për shkak të veprës penale fajdeja nga neni 343 par. 1 të KP-së. Gjatë shqyrtimit kryesor procedura penale është veçuar ndaj të akuzuarve L. P., F.1 dhe F. S.2 të cilit kanë qenë të paarritshëm për organet e ndjekjes.

Në fjalën përfundimtare Prokurori i shtetit ka mbetur pranë aktakuzës ndaj të akuzuarit P. M., për veprën penale fajdeja nga neni 343 par. 1 të KP-së duke precizuar shumë e dëmit të shkaktuar, ndaj të akuzuarit E. Th. dhe A. K., për veprën penale të detyrimit në bashkëkryerje por me ndryshim që ka eliminuar tentativën, të akuzuarin E. Th. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KP-së. Sa i përket të akuzuarit N. K. ka mbetur pranë aktakuzës për veprën penale fajdeja sipas pikës 4.1, ndërsa veprën penale fajdeja sipas pikës 4.2 ka rikualifikuar në veprën penale të detyrimit nga neni 340 par. 2 të KP-së duke precizuar edhe gjendjen faktike si në dispozitiv. Sa i përket të akuzuarit B. P. ka mbetur pranë aktakuzës për dy vepra penale të fajdesë nga neni 343 par. 1 dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose paautorizuar të armëve ne neni 374 par. 1 të KP-së. Sa i përket të akuzuarit E. M. ka bërë ri kualifikimin e veprës penale fajdeja në veprën penale të detyrimit nga neni 340 par. 1 të

KP-së, me precizimin e gjendjes faktike si në dispozitiv. Ndaj të akuzuari Gj. K., për veprën penale sipas aktakuzës në pikën 4.2 në bashkëkryerje me të akuzuarin N. K., ka hequr dorë nga ndjekja e mëtejme penale në mungesë të provave. Konsideron se në bazë të provave të administruara edhe atë me dëgjimin e të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe provave materiale, ekspertizave, raporteve të forenzikës, monitorimit të fshehtë të bisedave në vende publike dhe private të kryera në mobilierin "Ilsel", marrëveshjes së përpiluar me datën 25.04.2014, marrëveshjes së datës 10.12.2012, të lidhur ndërmjet të dëmtuarit B. M. dhe N. P., listës së armëve të konfiskuara më datën 14.07.2014, procesverbaleve mbi bastisjen, shikimit në DVD dhe CD si dhe raporteve të bisedave telefonike dhe foto dokumentacionit, vërtetohet se në veprimet e të akuzuarve janë formuar elementet e veprave penale të cilat u vihet në barë me ndryshimet e bëra në fjalën përfundimtare. Sa i përket të akuzuarit P. M., në bazë të mbrojtjes së tij dhe dëshmisë të dëmtuarve është vërtetuar se i dëmtuari I. ka marrë një hua nga P. M., në shumë prej 2.000 €, për të mjekuar vajzën e tij dhe se në shtator apo tetor të vitit 2013 i njëjti ka ardhur në shtëpi dhe ka kërkuar 6.800 €, ndërsa ai ka dhënë shumë prej 5.300 €, nga fakti se P. i ka thënë se prej asaj ditë deri kur ka paguar borxhin do të ngarkohet me kamat ditore nga 100 €. Shumën prej 5.300 € ka kërkuar vet P. dhe në momentin kur ia ka dhënë atë shumë ka qenë prezent vajza i të dëmtuarit S., Sh. K.. Ndërkaq është vërtetuar se të akuzuarit E. Th. dhe A. K. në mënyrë permanente kanë shitur automjete të dëmtuarit I. K. e më pas në pamundësi që i dëmtuari I. t'i mbulojë këto shpenzime kanë shkuar në shtëpinë e dëmtuarit S. K. duke pretenduar se I. ka borxh personave në Gjakovë dhe në Pejë dhe në dy raste nxjerrin nga 20.000 € dhe 25.000€, gjithsej 45.000€, duke e detyruar të dëmtuarit të pranojnë borxhet, si dhe kanë detyruar të dëmtuarin S. që të bëjë një marrëveshje për shitblerjen e shtëpisë edhe pse kanë ditur faktin se shtëpia në fjalë është nën hipotekë dhe se tekstin e kësaj marrëveshje i dëmtuari S. nuk e ka kuptuar sepse ka qenë e shkruar në gjuhën shqipe të cilën ai nuk e kupton mire, se të dy të akuzuarit në mënyrë permanente kanë shkuar secili mbi 20 herë duke përdorur kanosjen serioze për t'i detyruar të dëmtuarit që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre, kanë pretenduar se i dëmtuari ka borxh 150.000€ duke kërkuar që S. ta bartë shtëpinë në emër të të akuzuarit E. Th., se i akuzuari A. K. ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarve dhe me revole është kanosur se do t'i vras edhe fëmijët e tyre me qëllim që t'i detyrojë të dëmtuarit që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre. Po ashtu është vërtetuar se është gjetur arma në automjetet të cilat kanë qenë të parkuara para shtëpisë e të akuzuarit E. Th., me të cilat kinse ka kryer biznesin e tij të shitblerjes së automjeteve, e cila është konfiskuar. Është vërtetuar se në vitin 2013, i akuzuari N. K. ia ka dhënë shumë prej 2.500 € të dëmtuarit I. K. dhe në muajin mars të vitit 2014 ka shkuar në shtëpinë e tij dhe ka marrë shumë prej 6.700 € ashtu që dëmi i shkaktuar nga fajdeja ka qenë 4.200 €, i cili fakt vërtetohet në bazë të deklaratës së të dëmtuarit S. K. i cili ka dëshmuar se në lokalit të tij ka ardhur i akuzuari N. dhe e ka kërcënuar duke kërkuar shumë e përmendur me pretekst se djali i tij I. i ka borxh. Në bazë të dëshmisë së të dëmtuarve dhe audio incizimet po ashtu është vërtetuar se në muajin korrik të vitit 2014 i akuzuari N. sërish ka shkuar në shtëpinë e tij dhe ka kërkuar shumë prej 42.000 € në emër të borxhit që kinse I. i kishte borxh N. P., duke i thënë se po që se nuk paguan, kamata do të rritet. Nga deklarata e të dëmtuarit B. M. dhe marrëveshja e detyrueshme vërtetohet se i akuzuari B. P. prej shumës prej 1.500 € sa i ka dhanë B., ka nxjerr shumë prej 4.400 €, se kinse ia ka shitur të dëmtuarit I. një automjet dhe ia ka dorëzuar shumë prej 5.000 € me kamatë mujore prej 20%, e pastaj i dëmtuari S. ia ka dorëzuar gruas të akuzuarit shumë prej 7.000 €, si dhe se me rastin e bastisjes së kryer në shtëpinë e tij është gjetur një pistoletës tipit M 57 me një karikator dhe 8 copë fishek, e cila armë është konfiskuar nga polica. Sa i përket të akuzuarit E. M. përmes deklaratës së të dëmtuarit I. vërtetohet se nga momenti kur ka marr borxh prej 2.000 € nga babai i tij, P. M., në mënyrë permanente ka kërkuar dhe ka marrë borxh 200 deri 300 € në emër të kamatës e cila shumë është rritur në 5.300 €. Andaj propozon që të akuzuarit P. M., E. Th., A. K., N. K., B. P. dhe E. M. të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit. Në bazë të nenit 52 të KPP-së heq dorë nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit Gj. K. për veprën penale nën pik. 4/2 të

aktakuzës, sa i përket veprës penale fajde në tentativë nga neni 343 par. 1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KP-së, në mungesë të provave. Konformë nenit 69 propozon që të konfiskohet nga të akuzuarit të gjitha gjësendet e tjera si mjete të kryerjes së veprës penale.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarve, av. R. T. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se bashkëngjitet fjalës përfundimtare të Prokurori i shtetit dhe pajtohet me potencimin e provave në kuptim të ndërlidhjes me përgjegjësinë penale e të akuzuarve. Pajtohet me heqjen dorë nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit Gj. K.. Sa i përket kërkesë pasurore juridike në emër të dëmtuarve, kërkon kthimin e shumës së të hollave të cilat janë objekt i kryerjes së veprave penale.

Mbrojtësi i akuzuarit P. M., av. V. O. në fjalën përfundimtare deklaroi se me asnjë provë bindëse nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet se si element qenësor i veprës penale nga neni 343 par. 1 të KP-së, është shfrytëzimi i gjendjes së vështirë financiare, gjendjes së rëndë të banimit apo edhe të papërvojës së të dëmtuarve për të kontraktuar punë juridike me përfitim jo proporcional. Në bazë të provave të administruara nuk është vërtetuar asnjëra nga këto rrethana por është vërtetuar se të dëmtuarit kanë pasur gjendjen e mirë financiare dhe kanë qarkulluar shuma të mëdha të parave. Deklaratat e të dëmtuarve të dhëna në procedurë hetimore si dhe gjatë shqyrtimit kryesor janë kontradiktore, të pakuptueshme ashtu që nuk mund të falet besimi asnjëherë rrethanë. I dëmtuari I. në deklaratën e datës 19.08.2014, ka theksuar se të pandehurin P. M. e njeh 15 vjet, se jetojnë në një lagje, se nga ai ka marrë hua shumën prej 2.000 € dhe nuk ka biseduar për afatin e kthimit, por pasi kanë kaluar 4 muaj i akuzuari P. në fillim ka kërkuar prej 100 deri 200 € për çdo muaj e më vonë edhe 300 deri 400 €, pastaj 700 deri 900 € në muaj dhe përfundimisht ia ka kthyer shumën prej 8.800 €, ndërsa ka deklaruar se me datën 22.12.2014, i akuzuari P. M. ka marrë 2.300 € nga babai i tij S. K. kurse i dëmtuari I. nuk i ka dhënë para në dorë këtij të akuzuari. Në deklaratën e datës 08.04.2016m në shqyrtimin kryesor ka shtuar se me të akuzuarin P. M. ka pasur raporte shumë të mira dhe prej tij ka kërkuar ndihmë për një çështje të pagesës të veturës të marrë nga i dëmtuari M. R., ndërsa i dëmtuari S. K. ka dëshmuar se nga P. M. asnjëherë nuk ka marrë para borxh, se nuk e din që djali i tij I. të ketë marr para borxh dhe se asnjëherë nuk ka qenë prezentë kur P. M. ka ardhur dhe në prezencën e tij ka kërkuar para, por të njëjtit i ka dhanë shumën prej 5.300 €. Nuk është kontestuese se i mbrojturi i tij i ka huazuar shumën prej 2.000 € të dëmtuarit S. K. si komshi me të cilat i ka pas raportet e mira fqinjësore dhe kjo shumë i është kthyer atij, ndërsa 150 € kanë qenë për një kurban të cilën e kanë marr për festën e Kurban Bajramit. Në këtë procedurë ka dëshmuar M. R. se P. M. ka ndërmjetësuar me të dëmtuarit I. dhe S. K. lidhur me shitblerjen e veturës për shkak të besimit dhe raporteve të mira që kanë pasur në mesë vete dhe se i akuzuari P. M. së bashku me të dëmtuarin S. kanë paguar të hollat për veturën e marr nga I. dhe se P. ka ndërmjetësuar për shtyrjen e kohës të pagesës. Rrethanat e mëvonshme në familjen e të dëmtuarve kanë shtyrë që tanimë edhe të hollat e dorëzuara për këtë veturë të përfshihen si formë të kamatës dhënë të akuzuarit P. M., andaj propozon që gjykata në mungesë të provave në bazë të nenit 364 par. 3 të KPP-së i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza.

I akuzuari P. M. duke mbështetur fjalën e mbrojtësit në fjalën përfundimtare ka shtuar se në bazë të çfarë ekspertize prokuroria ka konstatuar shumën që e ka marr 5.300 € dhe në çfarë prova.

Mbrojtësi i akuzuarit E. Th., av. P. P. në fjalën përfundimtare deklaroi se për të ekzistuar vepra penale për të cilën akuzohet i mbrojturi i tij së bashku me të akuzuarit e tjerë duhet të vërtetohet dashja si element subjektiv i veprës penale për të realizuar qëllimin e përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, me përdorim

të forcës apo kanosjes serioze për të detyruar personin tjetër të kryejë apo të mos kryejë ndonjë veprim në dëme të pasurisë së tij. Prokurori i shtetit pranon që në mes të akuzuarit E. Th. dhe të dëmtuarit I. ka pasur marrëdhënie kontraktuese e cila reflektohet me faktin se i dëmtuari ka blerë disa automobila tek i akuzuari E., i cili në atë kohë është marrë me shitblerjen e automobilitave të përdorur. Ai ka pohuar se të dëmtuarve ua ka shitur 12 automobila, 2 automobila i ka shitur të dëmtuarit I. ndërsa 10 të tjera ia ka shitur të dëmtuarit S., për të cilat nuk kanë paguar asnjëherë vlerën e tyre, andaj vlera e këtyre automobilitave arin shumën prej 53.500 €, për të cilën shumë të dëmtuarit kanë qenë të detyruar ndaj të akuzuarit E.. Pra shitblerja e automjeteve në mes tyre paraqet një marrëdhënie juridiko civile. Nuk qëndron fakti i pretenduar me aktakuzë se kinse i akuzuari i ka shitur të dëmtuarit automobilat për një çmim më të lartë se sa ka mund të jetë çmimi i tregut të lire, pasi që nga mbrojtja e të akuzuarit dhe nga deklaratat e të dëmtuarit rezulton se të njëjtit kanë hyrë në marrëdhënie kontraktuese me vullnetin e tyre. Kur i dëmtuari I. e ka marrë dy automobilat e parë nga i akuzuari E., në muajin tetor – nëntor 2013 dhe i ka thënë të akuzuarit se janë duke e shitur shtëpinë e tyre familjare dhe mund të bisedojnë edhe për këtë çështje. Prandaj akuzuari nuk ka dashur të bisedojë vetëm me I. por ka kërkuar të bisedojë edhe me babanë e tij dhe në bisedë S. i ka thënë se e kanë vlerësuar shtëpinë në shumë prej 150.000 € dhe kanë arritur marrëveshjen që i akuzuari E. të blejë shtëpinë për këtë shumë, por çmimin e dakorduar do ta përmbushë në këste. Prej asaj kohe i akuzuari me shitjen e automobilitave tjera ka filluar të përmbushë detyrimin e tij kontraktues për blerjen e shtëpisë lidhur me pagimin e çmimit të kontraktuar. Të gjitha këto negociata të zhvilluara në mes tyre vërtetohen edhe me provat materiale edhe atë kontrata me shkrim si marrëveshje, e përpiluar me kompjuter dhe nënshkruar nga E. Th., S. K., I. K. dhe A. K., si dëshmitar i pranishëm, marrëveshja e shkruar me shkrim dore nga ana e të dëmtuarve ku të dy të dëmtuarit janë marrë veshë që t'ia shesin shtëpinë E. Th. për shumën prej 230.000 €, e nënshkruar nga S. K., E. Th. dhe I. K. si dhe me dëshminë e të dëmtuarve të cilët kanë vërtetuar se nga i akuzuari E. kanë blerë disa automobila dhe kanë qenë interesuar që të shesin shtëpinë e tyre duke arritur dy marrëveshje. I dëmtuari S. ka pasur detyrime në një bankë komerciale dhe ka pranuar se për realizimin e kredisë ka vënë në hipotekë bankare shtëpinë e tij dhe i akuzuari E. ka marrë për sipër që të bëjë pagesën e mbetur hipotekare dhe të lirohet nga hipoteka. Në bazë të incizimeve nga kamerat të vendosur për vëzhgim hetimor nuk rezulton se në ndonjë insert të mundshëm të ketë pasur kërcënim serioz për detyrimin që të veprojnë në dëme të pasurisë së tyre, në mes tyre janë zhvilluar bisedat spontane lidhur me lidhjen e marrëveshjes si dhe realizimin e marrëveshjes dhe mundësinë e kthimit të parave të cilët të dëmtuarit e kanë marrë në emër të shitblerjes së shtëpisë. Përveç dashjes si element qenësor të kësaj vepre penale duhet të ekzistojë përdorimi i forcës apo kanosjes serioze për detyrimin e personit. Duke pasur parasysh rrjedhjen e kësaj çështjeje, nuk rezulton që i akuzuari ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarve ose kërcënime serioze për detyrim dhe nuk është vërtetuar se të dëmtuarit nga efekti i dhunës të kenë bërë ndonjë veprim konkret i cili ka kontribuar në dëmtimin e pronës së tyre, ose se ka pasur tentativë për të ndërmarrë ndonjë veprim në dëm të pasurisë së vet, pasi që të gjitha veprimet e të dëmtuarve janë marrë me vullnetin e tyre të lirë. Sa i përket veprës penale posedimi i armës është vërtetuar se në dy vetura të tipit “Kia” dhe “Korado” të cilat kanë qenë të parkuara në rr. ..., janë gjetur dy armë, në njërin është gjetur një pushkë gjysmë automatike me nr. serik. 229956 dhe një pistoletë “Bereta” të kalbirit 7,62mm, me nr. serik V 730691. Në këtë drejtim gjykata duhet t'i kushtojë besim mbrojtjes së të akuzuarit, i cili ka deklaruar se të dy automobila ku janë gjetur armët, kanë qenë në posedim të të dëmtuarve, pasi që ata kanë pretenduar që t'i marrin këto automobila në emër të përmbushjes të çmimit të kontraktuar për shitblerjen e shtëpisë. Nëndërkohë të dëmtuarit i kanë përdorur automobilat dhe i kanë parkuar në vendin e caktuar e pastaj çelësat e atyre ia kanë dhanë babait të të akuzuarit ndërsa i akuzuari nuk ka pasur qasje në automobilat e përmendur, prandaj edhe nuk mund të rezulton se i njëjti i ka pasur në posedim këto automobila. Këto

fakte i kanë vërtetuar edhe vet të dëmtuarit. Propozon që në mungesë të provave i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza për veprat penale për të cilat akuzohet në mungesë të provave.

I akuzuari E. Th. duke u bashkangjitur fjalës së mbrojtësit të tij shton se nuk ka detyruar të dëmtuarit por ka kërkuar pasurin e tij në emër të automjeteve dhe të hollave për të cilat edhe të dëmtuarit vet kanë konfirmuar se i kanë marrë .

Mbrojtësi i akuzuarit A. K., av. B. N. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me aktakuzën e përmirësuar i mbrojturi i tij ngarkohet për veprën penale detyrimi në bashkëkryerje. Nëse pretendohet në kualifikimin bashkëkryerje si obligim i domosdoshëm i akuzës është që të përcaktohen decidivisht veprimin e çdo njërit prej pjesëmarrësve në kryerjen e veprës penale dhe rolin dhe kontributin thelbësor me veprimet konkrete sa i përket elementeve të veprës penale. Dispozitivi i aktakuzës me të cilën ngarkohet i mbrojturi i tij përmban dy pasuse me dy përskrime pretenduese, e para ka të bëjë me konstatimin se gjoja të akuzuarit u kanë shitur një numër të automjeteve të dëmtuarve me kanosje serioze, duke i detyruar që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre ashtu që këto automjete i paskan blerë me çmimet e ulëta ndërsa u ka shitur me çmime më të larta se sa që shiten në tregun e lirë, lidhur me këtë nuk kanë dhënë përgjigje e as provat e administruara nuk kanë vërtetuar këtë fakt. Gjatë shqyrtimit pamëdyshje është vërtetuar se i akuzuari A. K. ka shitur vetëm një automjet i cili ka qenë në pronësinë e tij dhe asnjë tjetër dhe çmimi për automjetin ka qenë i caktuar sipas marrëveshjes, në momentin e caktimit të çmimit A. nuk ka bërë çfarëdo lloj kanosje. Në këtë dispozitiv pretendohet se bashkëkryesit kanë marrë obligim që të mbulojnë të gjitha borxhet e I. K. të cilat ua kishte dy personave të paidentifikuar nga Gjakova dhe nga Peja, i cili borxh përmendet në shumë prej 45.000 €, të cilën shumë e paskan marrë bashkërisht dhe e paskan lënë në tavolinë. Gjatë administrimit të provave në asnjë moment nuk është vërtetuar veprimi lidhur me ato para. Pjesa e dytë e përskrimit faktik të aktakuzës është në kundërtënie logjike me vetveten, ku në fillim përmendet katër data e pastaj konstatohet se në pjesën e parë të muajit korrik të vitit 2014, i akuzuari E. Th. shkon më se 40 herë ndërsa A. K. më se 20 herë në shtëpinë e të dëmtuarit me pretendim se të akuzuarit i paskan kërcënuar të dëmtuarit të shesin shtëpinë në drejtim se do të vrasin tërë familjen. Në bazë të provave të administruara nuk vërtetohet që ka ekzistuar një kërcënim i çfarëdo lloji nga ana e cilitdo të bashkëkryerësve e më së paku nga i mbrojturi i tij. Në këtë drejtim aktakuza pretendon se gjoja të dëmtuarit nuk kuptojnë gjuhën shqipe dhe se atyre gjithmonë u është imponuar ndonjë letër e shkruar për të nënshkruar, por është fakt se ekspertiza grafologjike ka vërtetuar të kundërtën se të gjitha janë shkruar nga ana e të dëmtuarve . Në këtë çështje i mbrojturi i tij është i dëmtuar nga se atij i është marrë automjeti dhe deri më sot nuk i është paguar. Për të ekzistuar vepra penale për të cilën akuzohet dëmi në pasurinë e subjektit pasiv duhet të ndodhë, dëmi nuk mund të mbetet i pakryer, ndërsa rrezikimi eventual i pasurisë nuk është elementi i veprës penale. Pra në rastin konkret dëmi nuk ka ndodhur, nuk është kryer edhe pse mund të ekzistojë vetëm një raport civilo juridik ku përmbushja e obligimeve të marra është e njëanshme, ngase këto obligimet i kanë përmbushur vetëm të akuzuarit ndërsa të dëmtuarit vetëm i kanë shfrytëzuar. Dispozitat përkatëse të cilat janë të vlershme të zbatohen taksativisht përcaktojnë se i akuzuari nuk mund të shpallet fajtor vetëm në sajë të deklaratës së të dëmtuarve të cilat deklarata në rastin konkret janë shumë kontradiktore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të arrihet një kontinuitet përkatës i deklaratave i cili kontinuitet do të ishte logjik. Konsideron se në rastin konkret mund të merret vetëm një vendim dhe atë lirues në mungesë të provave.

I akuzuari A. K. në fjalën e vet përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e përkrah fjalën e mbrojtësit të tij .

Mbrojtësi i akuzuarit N. K., av. S. M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se sipas aktakuzës së parë i mbrojturi i tij akuzohet për dy vepra penale edhe atë fajdeja nga neni 343 par. 1 fajdeja në tentativë në bashkëkryerje nga neni 343 par. 1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KP-së. Me aktakuzën e ndryshuar në fjalën përfundimtare prokuroria ka ri kualifikuar veprën penale të fajdesë në bashkëkryerje në veprën penale të detyrimit nga neni 340 par. 2 të KP-së. Konsideron se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer këto vepra penale. Fakti se i akuzuari ka pasur një raport me të dëmtuarit I. dhe S. K. lidhur me shitblerjen e automjetit “Golf 4”, të cilin automjete e ka blerë në mënyrë të ligjshme me kontratë të autorizuar, për shumën prej 3.000 €, të cilën shumë ka paguar përmes xhirollogarisë së tij. Është fakt se i akuzuari të dëmtuarit, i cili ka kërkuar para ia ka huazuar shumën prej 2.000 €, me afat të kthimit për një muaj, pa as një kusht apo marrëveshje lidhur me çfarëdo provizioni apo kamatë. Nëse analizohen të gjitha deklaratat e të dëmtuarve I. dhe S. K., të dhëna në prokurori si dhe gjatë shqyrtimit kryesor, qartë vërehet se të gjitha këto deklarata ndryshojnë njëra prej tjetrës lidhur me pretendimet në drejtim të akuzuarit N. K., që ka të bëjë me shumën të ndryshme të parave çoftë të paguara apo të kërkuara. Sipas pikës katër të aktakuzës se i dëmtuari S. K. i ka paguar 6.400 €, të akuzuarit në emër të borxhit të cilin ia ka pasur djali i tij i dëmtuari I., kjo nuk është vërtetuar me asnjë provë dhe nuk është përmendur nga të dëmtuarit se këtë shumë ia kanë paguar të akuzuarit. Është fakt se i akuzuari disa herë të dëmtuarin ka kontaktuar me telefon duke kërkuar borxhin të dhënë prej 2.000 €, se i akuzuari ka qenë edhe në shtëpinë e tyre për të biseduar lidhur me afatin e kthimit dhe se të dëmtuarit vazhdimisht kanë kërkuar nga i akuzuari shtyrjen e afatit, sepse nuk kanë pasur mundësi të paguajnë, nga mbrojtja e të akuzuarit rezulton se në prezencën e të dy të dëmtuarve dhe të bashkëshortes së të dëmtuarit I., e cila ka lutur të akuzuarin që t’ia zbres këtë shumë, i akuzuari nga keqardhja shumë prej 2.000 € ka zbritur për 500 €, por kjo shumë deri më sot ende nuk iu është kthyer. Deklaratat e të dëmtuarve janë aq kontradiktore në mes vete sa që të njëjtat janë të pabesueshme dhe nuk kanë lidhje kauzale. Fakti se i akuzuari sipas aktakuzës së ndryshuar ngarkohet për veprën penale të detyrimit për shumën prej 41.000 €, duke i detyruar të dëmtuarit dhe kanosur seriozisht në mënyra të ndryshme, që t’ia paguajnë një personi me emër N. P., është i pakuptueshëm dhe me asnjë provë të qartë nuk vërtetohet se i akuzuari ka pasur çfarëdo lidhje me atë person dhe ky fakt nuk është përmendur nga të dëmtuarit. Në aktakuzë nuk janë përcaktuar metodat, mënyra dhe mjetet me të cilët është kryer kërcënimi dhe kanosja për tu përmbushur elementi i detyrimit i kësaj vepre, ndërsa fjalët e të akuzuarit “ky borxh duhet të paguhet dhe se për mos pagesë mund të ritet kamata”, len për të gjykuar se a është kjo formë e detyrimit dhe çfarë veprime apo mos veprime nga këto fjalë ka vepruar i dëmtuari si dhe a ka krijuar ndonjë pasojë që nga ky detyrim i dëmtuari të ketë paguar shumën prej 41.000 €. Nga të gjitha konsideron se i mbrojturi i tij do të lirohet nga përgjegjësia për të dy vepra penale për të cilat akuzohet në kuptim të neni 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPP-së në mungesë të provave.

I akuzuari N. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi i bashkëngjitet fjalës së mbrojtësit dhe nuk ka çka të shtojë.

Mbrojtësi i akuzuarit B. P., av. B. S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi i tij ngarkohet në tri pika të dispozitivit. Sipas pikës 5.1 i mbrojturi i tij ka pasur marrëdhënie të shitblerjes me të dëmtuarin B. M. rreth një automjeti, por nuk qëndron pretendimi se kinse është hartuar një procesverbal dhe në atë letër i dëmtuari e ka nënshkruar me vetë dëshirë duke pranuar se ka marrë të holla borxh prej B.. Sipas pikës 1 ku përshkruhet se e ka shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare duke përfituar për vete një shumë prej 7.000€, sipas mendimit të tij ky pretendim nuk qëndron. Të gjitha deklaratat e të dëmtuarve janë kontradiktore. Gjatë seancës gjyqësore me dëgjimin e CD-eve, audio dhe video incizimet, dëgjohet qartë biseda në mes të dëmtuarit S. dhe të akuzuarit B., ku S. deklaron se nuk ka marrë para me interes nga B.. Në shqyrtimin kryesor të dëmtuarit kanë deklaruar se kanë

blerë një automjet nga B. në shumë prej 7.000 € dhe të hollat në atë shumë i ka kthyer bashkëshortes së tij R.. Sa i përket veprës penale nga neni 374 par. 1 të KP-së, arma e cila është gjetur në shtëpinë e tij nuk është e B. sepse arma është gjetur në katin e dytë ky banojnë disa persona me qira ndërsa B. jeton në katin e tretë dhe nuk ka ditur për armën, kurse vëllai i tij jeton në katin e katërt. Për të ekzistuar vepra penale duhet të përmbushen disa elementet e veprës dhe për të besuar se të dëmtuarit janë me të vërtetë të dëmtuar duhet të ekziston dëmi i shkaktuar dhe duhet të përshkruhen disa veprime konkrete lidhur me motivet që do të na qojnë në drejtim për të kuptuar se i mbrojturi i tij ka pasur përfitim pasuror. Propozon që i njëjti në kuptim të nenit 364 par. 1 pik. 1.3 të KPP-së, në mungesë të provave të lirohet nga akuza.

I akuzuari B. P. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalët e mbrojtësit duke shtuar se e lut trupin gjykues që të merr aktgjykim të drejtë sepse nuk e ndien veten fajtor për veprat penale për të cilat akuzohet dhe se si qytetari i thjeshtë ka të drejtë të shesë dhe të blejë vetura, në këtë raste ka shitur një veturë për të cilën i ka paguar S. K. .

Mbrojtësi i akuzuarit E. M. av. Sh. B. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se fjalën përfundimtare me shkrim e ka përgatitur për veprën penale fajdeja sipas aktakuzës e parë. Pas ndryshimit të aktakuzës i mbrojturi i tij akuzohet për veprën penale të detyrimit nga neni 340 par. 1 të KP-së, andaj duke u bazuar në parimin “beneficium kohezionis” i përkrah të gjitha fjalët e mira të kolegëve që vlejnë për të akuzuarit e tjerë dhe vlen edhe për të mbrojturin e tij. Konsideron se me asnjë provë të tërthorte – indirekt nuk vërtetohet se i mbrojturi i tij të ketë detyruar të dëmtuarit I. K. të kryejë apo të mos kryejë ndonjë veprim në dëm të pasurisë së vet, me përdorimin e forcës, ose me kanosje serioze e me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore dhe me këtë të ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barë sipas aktakuzës së ndryshuar. Gjatë të gjitha seancave është vërtetuar se i mbrojturi i tij dhe i dëmtuari I. K. janë shokë, jetojnë në një rrugë, kanë pasur hyrje dalje, gjithnjë kanë pasur mardhanë të mira dhe se asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje. I akuzuari asnjëherë nuk i është kërcënuar dhe nuk ka marrë para nga ai as në emër të vet e as në emër të babait të tij, të akuzuarit Palë. Në deklaratën e të dëmtuarit të dhënë në seancën e datës 08.04.2016 i dëmtuari në mes tjerash ka deklaruar se “ nga E. nuk kam marr asnjë cent”. Elementi qenësor i kësaj vepre penale për të cilën i mbrojturi i tij akuzohet është kërcënimi dhe përdorimi i forcës. Me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kërcënuar të dëmtuarit apo të ketë përdorur ndonjë forcë. Kërcënimi duhet të jetë serioz, i drejtpërdrejtë, i arritshëm, i cili do të ndikojë tek personi tjetër të kryejë apo të mos kryejë ndonjë veprim dhe forca duhet të jetë reale dhe e drejtpërdrejtë. Asnjëherë nuk është vërtetuar se i akuzuari E. në mënyrë më të lehtë të ketë kërcënuar të dëmtuarit e as të ketë përdorur çfarëdo force ndaj tij. Andaj propozon që i mbrojturi i tij në mungesë të provave të lirohet nga akuza.

I akuzuari E. M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështet fjalën e mbrojtësit duke shtuar se nuk e ndien veten fajtor, me I. K. janë komshi dhe 18 vite jetojnë në një lagje, prej ditës së parë deri më sot për shkak të raporteve të mira që kanë pasur edhe ka prerë kurbanin në shtëpinë e tij.

I akuzuari P. M. në mbrojtjen e vet ka mohuar kryerjen e veprës penale duke dhënë versionin e vet se në vitin 1997 ka blerë një shtëpi në Prizren e cila shtëpi është në një distancë rreth 100 metra prej shtëpisë e të dëmtuarve dhe në atë shtëpi jeton biri i tij E. me familjen e vet. Nuk i kujtohet data e saktë në vitin 2012, derisa ka punuar në tregun afër gjimnazit në Prizren duke shitur deshe, ka ardhur S. K. dhe ka kërkuar hua në shumë prej 2.000 € duke treguar se i kishte vdekur bashkëshortja dhe ka obligime. Kjo situatë e ka prekur andaj nga xhepi ka nxjerr 2.000 € dhe ia ka dorëzuar në dorë ,i cili i ka premtuar se brenda 10 dite do t’ia kthejë. Atë ditë S. ka blerë edhe një dash për kurban në shumë prej 150 €, të cilën

shumë ka paguar 3 dite pas festës së Bajramit. Nuk i kujtohet saktë, kur kanë kaluar rreth 7 muaj S. ka ardhur në shtëpinë e tij në Prizren dhe ka kërkuar që të garantojë për borxhin që u kishte dy personave nga fshati K., të cilin nuk i ka njohur, ka qenë në pyetje 4.000 € dhe në bisedë me ata persona ka kuptuar se djali i S. ka blerë një veturë për 4.000 €, ashtu që ata persona kanë ardhur në shtëpinë e S. për të marrë veturën. Prej atyre personave ka kërkuar që të presin S. edhe 3 javë për të paguar borxhin dhe ka garantuar se nëse borxhin nuk e paguan S. do të paguajë ai. Pasi kanë kaluar tre javë personi me emër M. ka thirrur në telefon dhe i ka thanë se S. nuk ka paguar të hollat prandaj të njëjtën ditë në mbrëmje ka vizituar S. në punëtorin e tij dhe atëherë S. i ka treguar se ka siguruar 2.000 € dhe së bashku kanë shkuar në lokalën e M. ku i kanë dërguar ato para dhe ka biseduar me M. që për borxhin e mbetur të presin S. edhe dy javë, me të cilin fakt është pajtuar M.. Pas dy javë dite përsëri me S. kanë shkuar dhe kanë paguar edhe 2.000 €. Nuk është e vërtetë se të dëmtuarit I. në vitin 2010 i ka dhanë të holla, se nga I. K. ka kërkuar e as që ka marr ndonjë përfitim për të hollat të cilat i ka dhanë S. K. dhe nuk është e vërtetë se përmes djalit E. ka kërkuar nga I. të merr të holla me provizion nga E. Th., N. K., F.1 apo F. S.2, këto janë montime të policisë.

Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se i kujtohet mirë se diku në vitin 2011 apo 2012, kur ka vdekur gruaja e S., i njëjti ka ardhur në shtëpinë e tij për të kërkuar borxh dhe duke kuptuar gjendjen e tij pikëlluese, si komshi ia ka dhanë 2.000 € edhe pse S. ka treguar se do të kthejë për 10 – 15 ditë, për shkak të raporteve të mira i ka thanë se kjo punë nuk diskutohet dhe pas dy muaj e gjysmë S. ia ka kthyer 2.000 €. Djali i tij E. ka ditur se S. i ka huazuar shumën prej 2.000 € por asnjëherë nuk e ka dërguar atë për të kërkuar huan.

I akuzuari E. Th. në mbrojtjen e vet ka mohuar kryerjen e veprës penale duke deklaruar se jeton në lagjen ..., shtëpia e tij është afër 200 metra larg nga shtëpia e të dëmtuarve. I kujtohet se në tetor të vitit 2013 me S. K. ka biseduar për t'ia blerë shtëpinë, çmimi fillestar ka qenë 150.000 € dhe marrëveshja ka qenë që atij t'ia japë edhe automjetet, pasi që merret me shitjen e veturave, prandaj S. i ka dhanë gjithsejtë 14 vetura në vlerë të përgjithshme prej 55.000 €. Kompensimi ka filluar në muajin tetor të vitit 2013 dhe kanë vazhduar deri në muajin prill të vitit 2014 dhe gjatë asaj kohe pronarit të shtëpisë i ka dhënë edhe 96.200 €, për të cilën shumë posedon dokumente të cilat ia ka dhanë në dorë S. K. ashtu siç ka kërkuar ai, por nuk posedon kontratë me shkrim sepse kur ka shkuar tek noteri afër restorantit "Rezidence", notarja ka kërkuar dëshmi që pagesa është bërë përmes bankës, por meqë nuk kishte një dëshmi të tillë sepse të hollat i ka dhanë në dorë dhe nuk ka pasur edhe pëlqimin e bankës sepse shtëpia ka qenë nën hipotekë, andaj nuk ka mundur të bëjë kontratën. Është e vërtetë se ka kërkuar që shtëpia të bartet në emër të tije por nuk është e vërtetë se i ka kërcënuar ata, sepse S. i ka shtuar çmimit të shtëpisë edhe 80.000 €, duke kërkuar 30.000 € për pagesën e kredisë ndërsa 50.000 € për nevojat e veta, por këtë çmim nuk ka pasur mundësi të paguaj. E njeh P. M. sepse është nga fshati G., nuk e njeh N. K., F.1 dhe F. S.2 i njeh sepse jetojnë në Prizren, L. dhe N. P. nuk i njeh ndërsa A. K. e ka djalë të dajës dhe ka njohuri se A. S. i ka shitur një veturë të tipit "Mercedes" për 2.500 €, të cilën shumë nuk ia ka paguar ende dhe të gjitha bisedat ka pasur vetëm me S. K.. Automjeti ku është gjetur arma edhe atë një pushkë gjysmë automatike është e tipit "Korado" ndërsa automjeti në të cilën është gjetur pistoletë është "Kia", të dy automjete kanë qenë të parkuara në një distancë prej 30 metra nga shtëpia e tij, të cilat me datën 24.05.2014 i ka kthyer vetë I. dhe çelësat i ka dhanë babait të tij P. Th., ndërsa ai nuk i ka hapur automjetet prandaj nuk e pranon se armët janë të tijat, asnjëherë nuk ka dhanë të holla me fajde dhe çdo bisedë ka pasur vetëm me S. K..

Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se Ibrahimit i ka dhanë personalisht dy vetura edhe atë një "Kombi VW" dhe një veturë "BMW", për shumë prej 7.500 €, ndërsa S. i ka dhënë veturat edhe atë: "Pikap Citrien Berlingo", në shumë prej 4.000 €, "BMV" 525 për 3.500 € ,

“Ford Eeskord” për 2.000 €, “Fiat Uno” për 2.000 €, “Opel Calibra” 2.500 €, “Pezho 406 “ për 4.000 €, “Golf 2” për 2.500 €, “Mercedes 190” për 3.000 €, “Mercedes 300” për 10.000 €, “VW Bora” për 8.000 €, “Opel Cadet” për 1.500 € dhe një shvajc aparat për 1.500 €, kjo punë ka filluar prej muajit tetor 2013 me I. dhe ka përfunduar në prill 2014 me S. dhe vlera e përgjithshme e automjeteve ka qenë 53.800 €. Nuk e di çka kanë bërë me ato automjete, nuk i ka parë duke i vozitur, kanë ardhur tek shtëpia dhe kanë marr disa automjete dhe nuk e di ku i kanë dërguar, por e di se veturat “Bora”, “Mercedes” dhe “Kombi”, personalisht i ka dërguar tek lokali i tyre. Kur ka kërkuar prej S. dhe I. që ta realizojnë marrëveshjen rreth shitblerjes e veturave përgjigja e tyre ka qenë se ato vetura do t’i shesin dhe kanë obliguar blerësit të bëjnë autorizimin ose kontratën. Sa i përket veturave “Kia” dhe “Korado”, S. e ka thirrur në telefon dhe ka kërkuar një shumë të konsiderueshme të hollash, por pasi nuk ka pasur ia ka dhanë këto dy vetura dhe të njëjtën ditë derisa ka punuar në garazhdën S. së bashku me I. kanë ardhur dhe kanë marrë të dy vetura. Çmimi i veturës “Korado” ka qenë 2.500 € ndërsa “Kio” 2.000 € apo 2.500 €, përveç veturave që ia ka dhanë S. i ka dhanë edhe të holla sepse ka qenë i interesuar për blerjen e shtëpisë, një herë i ka dhanë 8.000 € pastaj 5.000 €, përsëri 5.000 € diku në muajin shkurt të vitit 2014, njëherë në muajin shkurt 7.500 €, në muajin mars 4.000 € dhe 6.200 €, pastaj pasi që ka mbetur pa para dhe ka qenë i detyruar të merr borxhe herën e fundit i ka dhanë 11.500 €, e para kësaj edhe 20.000 € në lokalit e tij duke i lënë në makinën që prodhon federa dhe 25.000 € kur ka qenë prezentë edhe I. edhe A., në atë momente I. i ka dhanë një letër të cilën e kanë nënshkruar me një tekst se I. dhe S. u ka dhanë 150.000 €. Në atë letër ka pasur vërejtje sepse ka qenë e shënuar se “unë S. K. me djalin I. K., E. Th. i kemi borxh 150.000 € të cilat i kemi marr tri herë nga 50.000 €”, sepse ka dashur të përmend edhe veturat dhe shifrën e saktë të parave. Atë ditë kanë marrë vesh edhe për shitblerjen e shtëpisë dhe bartjen në emrin e tij, por ai nuk i është përmbajtur sepse shtëpia ishte nën hipotekë. Kur ka shkuar në shtëpinë e S. i cili e ka thirrur me telefon, gjatë bisedës kur S. ka kërkuar borxhin, i ka ofruar një marrëveshje tjetër me të cilën ka kërkuar që të shtojë edhe 80.000 € të tjera për blerjen e shtëpisë, prej të cilës shumë 30.000 € për hipotekë e 50.000 € për t’ia dhënë S. . Marrëveshjen ka pranuar duke menduar se me atë do të kryejnë këto punë sepse edhe vet ka hyrë në borxhe. Këtë shumë nuk e ka paguar por ka kërkuar që të shkojnë tek noteri dhe të fillojnë procedurën për blerjen e shtëpisë. Së bashku me S. kanë qenë tek noteri afër restorantit “R.” dhe kanë pyetur çka duhet për bartjen e shtëpisë, notarja i ka informuar se duhet një vërtetim nga psikiatri për personin i cili është pronar sepse është mbi 65 vjeç, por pasi që S. nuk ka siguruar këtë dokument dhe nuk ka lejuar që të bëhet transferimi i parave përmes bankës, nuk është zbatuar edhe marrëveshja. Ai ka vazhduar t’i kërkojë parat e veta dhe nga S. ka marrë përgjigje se do t’i kthejë parat, atëherë kanë lënë disa data për kthim, por asnjëherë nuk është përmbajtur. Gjithmonë S. ka përmendur se shtëpinë e ka shitur dhe po presin transferimin e parave herë nga personi nga Danimarka herë nga Zvicra dhe nga vendet të tjera. Nuk i kujtohet saktë, por ka shkuar 5 - 6 herë në shtëpinë e tij dhe asnjëherë nuk ka pasur pistoletën me vete. Ka qenë ndërmjetësues në shitjen e veturës “Mercedes”, pronë e A. K. sepse ai merret me shitjen e veturave dhe A. ka pasur nevojë për ta shitur atë.

I akuzuari A. K. në mbrojtjen e vet ka theksuar se I. K. e njeh që nga viti 2014 kur ia ka shitur një veturë të tipit “Mercedes 250 -20 “, i njëjti ka ardhur në shtëpinë e tij së bashku me E. Th. dhe marrëveshja ka qenë që çmimi të paguhet në fillim të muajit maj të vitit 2014. Në fillim të muajit maj ka shkuar në shtëpinë e I. K. tri herë për të kërkuar të hollat por ai është ankuar se nuk ka. Është e vërtet se së bashku me E. Th. kanë shkuar në shtëpinë e I. dhe e kanë nënshkruar një marrëveshje të cilën përmbajtje nuk e ka lexuar para se ta nënshkruante dhe nuk është e vërtet se të dëmtuarin I. ka kërcënuar se do të vrasë, do t’ia marrë fëmijët dhe fjalë tjera kërcënuse për t’ia imponuar atij që ta shesë shtëpinë me çmim prej 230.000 €. Është e vërtet se e ka nënshkruar një letër me përmbajtje se i dëmtuari I. K. ia ka borxh të pandehurit E. Th. në shumë prej 109.400 €. Atë ditë ka kaluar afër shtëpisë së I. duke e

përcjell vajzën e tij deri te shtëpia e hallës dhe në lokalën e I. është takuar me E. Th. ashtu që I. dhe E. i kanë thanë që të nënshkruajë një letër si dëshmitarë, gjë që ka pranuar, në atë moment ka dëgjuar një bisedë në mes të tyre ku I. dhe E. kinse kanë dashur të punojnë si ortakë, si dhe bisedë për shitjen e shtëpisë.

Në shqyrtim kryesor ka shtuar se me I. K. ka ardhur në kontakt përmes nipit E. Th., se në atë kohë ka pasur një veturë markës “Mercedes” për të cilën gjë ka diskutuar me E. i cili ka gjetur si blerës I. Me I. nuk ka pasur ndonjë marrëveshje për afatin e pagesës dhe deri më sot ai nuk e ka konpenzuar çmimin e blerjes, prandaj për këtë ka shkuar në shtëpinë e tij një herë. Asnjëherë nuk ka ndodhur që ka shkuar për të dhënë shumën e parave prej 45.000 € e as të kërkojë borxhin që ata kanë i pasur E. Th. por për E. e din sepse ka qenë dëshmitarë kur ka dhanë një shumë të parave për blerjen e shtëpisë dhe ka nënshkruar marrëveshjen në lokalën e tyre.

I akuzuari N. K. në mbrojtjen e vet ka theksuar se I. K. e njeh që nga muaji mars – prill të vitit 2014, prej tij ka blerë një veturë të tipit “Golf 4”, ngjyrë hiri për çmim prej 3.000 € dhe atë shumë i ka paguar menjëherë në zyrën e noterit e cila gjendet përball ndërtesës së prokurorisë. Asnjëherë nuk i ka dhënë asgjë hua e as që ka shitur diçka Ibrahimit ndërsa babait të tij S. K. i ka dhanë 2.000 € hua në muajin maj të vitit 2014 me marrëveshja që t’ia kthejë pas një muaji. Pas kalimit të afatit prej një muaj është e vërtetë se ka kërkuar të holla përmes telefonit dhe ka shkuar 2 – 3 herë brenda 2 – 3 muajve duke kërkuar hua prej S. në shtëpinë e tij dhe në fund, me datën 11.07.2014 e ka ftuar S. dhe në prezencën e I. dhe bashkëshortes së tij, me kërkesën e bashkëshortes ka zbritur borxhin për 500 €, biseda ka qenë që me datën 14.07.2014 të paguajnë, mirëpo ai borxh ka mbetur edhe sot i papaguar, por asnjëherë nuk është zhvilluar kurrfarë biseda për provizion.

Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se ka vërejtur se një veturë pos hitet dhe ka pasur numrin e telefonit, pasi që ka qenë i interesuar ka thirrur atë numër dhe ka kontaktuar me I. të cilin e njeh sepse prej tij ka blerë një veturë në vitin 2013 e markës “Golf 4” të cilën veturë e ka paguar përmes bankës 3.000 €, kanë bërë kontratën për shitblerjen te noteri dhe është bërë bartja e veturës në emrin e tij. Edhe para blerjes së veturës i kujtohet se me telefon e ka thirrur I., ka shkuar në shtëpinë e tij dhe në prezencën e I., S. ka kërkuar 2.000 € për arsye se djali i I. ka qenë në spital dhe ka pasur nevojë për të holla për shërim, me obligim që pas një muaji do t’ia kthejë, por nuk e kanë kthyer deri më sot dhe gjithmonë në bisedë ka marrë përgjigje se duhet të presë edhe një javë apo dy . Kur ka shkuar ta kërkojë borxhin, bashkëshortja e I. e ka lutur që ta zbres borxhin sepse nuk kanë mundësi ta kthejnë, prandaj edhe ka hequr 500 € ashtu të borxhi ka mbetur 1.500 €. Asnjëherë gjatë vitit 2014 nuk ka shkuar në lokalën e S. të kërkojë shumën prej 41.300 €, për të cilat e din se të kujt janë, ato janë borxhi i cili I. ka ndaj N. P., këtë ka kuptuar atë ditë kur vetë ka shkuar në lokalën e I. dhe S., kur S. i ka thanë se të hënën do t’ia kthejë të gjithë borxhet që i ka, aty ka qenë edhe djali i N. P. i cili ka kërkuar parat e veta, nuk është sigurt sa por sa i kujtohet ka qenë shuma prej 40.000 €.

I akuzuari B. P. në mbrojtjen e vet ka theksuar se e njeh S. K. i cili posedon një punëtori në shtëpinë ku jeton dhe i cili merret me prodhimin e kauçave, në të cilën shtëpi jeton edhe biri i tij I. K.. Para 6 muajve vëllai i tij N., i cili punon dhe jeton në Suedi, i ka lënë në shtëpi për ta shitur një veturë të tipit “Audi” të prodhuar në vitin 2004, andaj në veturë e ka vendosur numrin e telefonit për kontakt me të interesuarit. I. e ka ftuar në telefon dhe e ka pyetur se a është i interesuar që të shesë veturën. Andaj prej I. ka kërkuar që të marrë babanë e tij S. për të biseduar lidhur me shitjen e veturës. Në momentin kur ka ardhur S. në lokalën e tij kanë zhvilluar një bisedë, çmimi i automjetit ka qenë i vendosur në letër edhe atë 10.000 € mirëpo atyre u ka shitur për 8.000 € dhe janë marrë veshë për pagesë brenda tre muajve,

kanë hartuar një marrëveshje me shkrim dhe një kopje e ka marrë, por S. kur ka paguar të hollat e ka marrë marrëveshjen, S. të hollat i ka dhanë bashkëshortes R. sepse ia në atë moment nuk ka qenë në shtëpi. Pas tre dite I. ka kërkuar të holla në shumë prej 1.000 € për të mjekuar djalin e tij duke premtuar se do t'ia kthejë në afat prej 4 muajve edhe pse i ka thanë që mund të paguajë kur ka mundësi Me datën 10.06.2014 në shtëpinë e tij kanë ardhur S. K. dhe ka kërkuar 10.000 € hua për të mbuluar një borxh për një person në Gjakovë, me te ka ardhur edhe I., të hollat i ka dhanë pas tre dite, e ka shkruar në një letër se e ka dhanë huan dhe deri në përfundimin e vitit 2014 në dëshmi nuk e kanë shkruar afatin e kthimit por ashtu janë marrë veshë. Një ditë S. e ka ftuar në telefon dhe kur ka shkruar në lokalën e tij aty ka gjetur dy persona nga Gjakova të cilët kanë ardhur për të kërkuar të hollat. Asnjëherë nga S. nuk ka kërkuar asgjë më tepër se aq sa i ka pasur borxh. Është e vërtetë se kur ka shkruar në lokalën e S. një herë e ka takuar E. Th. i cili i ka thanë se dëshiron të blenë shtëpinë e S., aty ka qenë edhe A. K. i cili i ka thanë se I. i kishte borxh 1.000 €. Asnjëherë nuk i ka thirrur në telefon të dëmtuarit por ata kanë thirrur.

Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se e njeh B. M. prej të cilit ka blerë një kamion me çmim prej 8.800 € dhe të njëjtën ditë i ka dhanë 4.000 € e për pjesën tjetër janë marrë veshë që t'ia kthejë kur të shkon për ta marrë kamionin, mirëpo kur ka shkruar për të marrë kamionin axha i B., H. M. i ka thanë se nuk pajtohet me shitjen sepse dokumentet nuk janë në rregull, pastaj pas 4 – 5 dite kur i kanë rregulluar dokumentet B. e ka thirrur me telefon dhe pasi ka marrë kamionin ka paguar pjesën tjetër prej 4.800 €. Më herët nuk e ka njohur I. por kur në vitin 2014 prej fshatit V. ka kaluar në Prizren në një rast gjatë shitjes së një veture “Audi” pronë e vëllait i cili jetonë në Suedi, në mes shumë personave të interesuar për blerjen ka qenë edhe I. i cili përmes telefonit ka kërkuar që të takohet lidhur me veturën. Janë takuar tek shtëpia e tij, në lokal dhe janë marrë veshë për çmimin e veturës 8.000 €, atëherë I. i ka thanë se për momentin nuk ka para dhe ka kërkuar një afat prej dy muaj por në fund janë marrë veshë që ta presë tre muaj. Gjatë bisedës me I., S. nuk ka qenë prezent, borxhin e ka paguar S. i cili ka qenë mirënjohës për pritjen dhe i ka thanë “mos i jep para borxh e as vetura djalit tim se ka dalë jashtë rrugës, është tu luajt kockë nëpër kazino dhe më ka shti në borxh”. Brenda një apo dy muaj I. ka ardhur me bashkëshorten dhe ka kërkuar 10.000 €, meqë S. e ka lutur që mos t'ia jep para, ka shkruar në shtëpinë e tyre për ta takuar dhe informuar S. se I. kërkon 10.000 €, ka vërejtur kur ata kanë biseduar në mes vete në gjuhën turke dhe pas bisedës S. ka thanë që mund t'ia japë paratë Ibrahimit dhe ato do t'ia paguajnë pas shitjes së shtëpisë. Deri sa kanë pirë kafe I. ka përpiluar një marrëveshje me tekst se po të shesë shtëpinë do të kthejë paratë prej 10.000 €. Kur ka shkruar të kërkojë paratë, sepse ata kanë folur se e kanë shitur shtëpinë dhe kanë përgatitur paratë dhe presin që të bëhet pagesa nga personi i cili jeton në Zvicër, por më vonë ka kërkuar se ato fjalë kanë qenë vetëm mashtrime dhe deri më sot nuk i kanë kthyer.

I akuzuari E. M. në mbrojtjen e vetë ka deklaruar se S. dhe I. e njeh që nga viti 1995 – 1996 sepse babai i tij është vendosur me shtëpi në Prizren, në rrugën në të cilën jetojnë edhe ata. Asnjëherë as S. e as I. prej tij nuk kanë kërkuar të holla por ka njohuri se para 3 vite kur ka vdekur bashkëshortja e S. nga babai i tij ka kërkuar 2.000 € hua dhe nuk ka ndodhur që në emër të huas të kërkojë ndonjë kamatë për atë shumë që e ka dhanë babai i tij dhe nuk është e vërtetë se babai i tij ka kërkuar kamatën për të holla që i ka dhanë S..

Gjatë shqyrtimi kryesor janë administruar provat materiale edhe atë me leximin e:

- procesverbalit mbi bastisjen e banesës dhe personave të datës 14.07.2017, në rrugën M. Th., pronë E. Th. ku gjatë bastisjes janë gjetur 4 copë fletë (letra) të shkruara me dorë dhe një letër e shkruar në kompjuter dhe një telefon “Ajfon 4”. Në veturën “Kia FA” me targ. *numri i targës...*, pronë e E. Th. është gjetur nën karrigen e pasagjerit të parë, një pistoletë

“P Bereta”, kalibrit 7,65mm , nr.V 730691 made in Itali dhe një karikator, dy fishekë të pa shkrepur, një librezë për veturën në emër të Z. K., në veturën “VW” me targa *numri i targës...*, pronë e E. Th., në bagazhe është gjetur një pushkë gjysmë automatike me nr. 229956, një librezë në emër të I. H. , në veturën “Gjip Tata” ne targ. *numri i targës...*, pronë E. Th., është gjetur një copë letër .

- procesverbalit mbi bastisjen e banesës dhe personave, me datën 14.07.2014, në rr. “Papa Gjonë Pali II” pronë e B. P. , është gjetur një pistoletë “TT” , 7.62mm, M 57, numri serik C 45291, një karikatorë, 8 fishekë të pa shkrepur, një kopje fletore , 9 fletë pagesa , një deklaratë dhe 2 fleta të shkruara .

-listës së dëshmimeve dosja e forenzikës TK-86-2014 lidhur me kontrollin e datës 14.07.2014 lidhur me sendet e konfiskuara gjatë kontrollimit në shtëpinë e E. Th. dhe në veturat pronë e E. Th. dhe në shtëpinë e B. P..

-listës së armëve të konfiskuara të datës 14.07.2014, D# 5 pistoletë “Bereta”, kalibr 7,65mm numër serik V730691, karikator i zbrazët dhe D# 7 një pushkë gjysme automatike me nr. serik 229956 dhe D# 4 dy fishekë me mbishkrimin F&B, 7.65 Br në të cilën ekziston nënshkrimi i dëshmitarit Xh. M. ndërsa në vend ku duhet të qëndroj nënshkrimi i të dyshuarit qëndron konstatimi “refuzohet”;

-listës së armëve të konfiskuara të datës 14.07.2014 me të cilën konfiskohen një pistoletë “TT” kalibar 7,62mm nr. serik C 45291, M 57 dhe një karikator në të cilën ekziston nënshkrimi i dëshmitarit G. P. ndërsa në vende ku duhet të qëndroj nënshkrimi i të dyshuarit qëndron konstatimi refuzohet;

- marrëveshjes të cilën e ka nënshkruar E. Th., A. K., S. K. dhe I. K. me përmbajtje “ unë S. K. dhe biri I. K. kemi bërë ket marrëveshje nëpërmjet E. Th. dhe A. K. për shitblerjen e shtëpisë që e posedoj në emër tim nga se une me të birin tim i kemi marrë borxh 150.000 € nga keta për nevojat tona personale dhe nëse deri me datën 25.04.2014 nuk i kthej këto para obligohem të ja shes shtëpinë që e kemi lenë me marrëveshje po me çmimin e lartepërmendur dhe keto para i kemi marrë pa kurrfarë interesi unë S. K. me të birin I. K. parat i kemi marrë kesh në tri rata nga 50.000 € me datën 12 02 2014 dhe 20 02 2014 dhe 25 02 2014 për të kthyer me datën 25 04.2014 të gjitha ket marrëveshje apo kontrat e bejmë pasi shtëpia momentalisht është në hipotek edhe ne e bejmë ket marrëveshje dhe në momentin kur tija pagujaj kredit në bank unë obligohem tija pagujaj kredit në bank unë obligohem tija transferoj në emër të lartepërmendurve ky dokument behet në praninë e tyre personave pa kurrfarë presioni por me vet dëshirë dhe ky dokument vlen vetëm për ket marrëveshje.”.

-raportit të ekspertimit nr. i referencës AKF/2017-2204/2017-1984 të datës 24.07.2017 lidhur me ekspertimin e dorëshkrimit në dokumentin marrëveshje evidentuar me D# 1 dhe krahasimi me dorëshkrimet mostrat të njohura të evidentuar në dëshmi D# 2, fleta të formatit A4 me dorëshkrim dhe nënshkrim të E. Th. dhe dëshmia evidentuar me D#3, fletë të formës A4 me dorëshkrim dhe nënshkrim të I. K. ku në konstatimin dhe mendimin përfundimtar është vërtetuar se në bazë të rezultatit të ekspertimit dorëshkrimi i evidentuar në dëshmi D# 1 dhe dorëshkrimet mostrat të njohura të evidentuar në dëshmi D# 2 nuk janë të shkruara nga personi i njëjtë, ndërsa dorëshkrimi i evidentuar në dëshminë D# 1 dhe dorëshkrimet mostrat e njohura të evidentuara në D# 3 janë të shkruara nga personi i njëjtë;

- fotokopjes së një faqeje nga blloku në të cilën është konstatuar se: “ baba i B. ka mi dhan B. me 5.5.014 dhe mu shly meta 30.00 ero” ku qëndrojnë dy nënshkrime nën një I. K. nën dy B. P.;

-një flete A4 me përmbajtje shumë të hollave ku në reshtin e parë është konstatuar 2.000 €, 15%- 8.800| € P. M., 1.600 € 20%- 2.600 € E. – Th., 3.500 € “Fiat - 7 vetura ndërsa E. – 10.800 € , 3.700 € 20 % B. P. – dy muaj – 7.000 €, kthim S.;

- përmbajtjes në fotokopjen e letërnjoftimit B. M. në të cilën është shënuar : un B. M. i mora prej N. P. me 10.12.20012. 4.000 € borgj, numri *numri i telefonit...*, në të cilën ekziston nënshkrimi nën 1 B. M. nën 2 emri N. P. ;-

-përmbajtjes së shkruar në fotokopje e letërnjoftimit I. K. ku është konstatuar se: I. K. i murr te B. me 30.9.013 5.000 €, me 25.10.013 2.000 € në të cilën nën 1 është nënshkrimi I K. dhe nën 2 B P.;

- përmbajtjes së shkruar në fotokopje letërnjoftimit I. K. në të cilën është konstatuar se I. K. ka mija dhan B. me 20.3.014 borxh mi dhan fill 7.000 € kamarr këto pare me 28.1.014.

-është bërë shikimi në fotoalbum nr. dosjes 2014-GI -80 të datës 04.07.2014, lidhur me bastisjen në: shtëpinë e të akuzuarit E. Th., ku janë gjetur dëshmitë nr. 9 një copë letër prej kartoni, disa letra me shënime evidentuar me dëshmi 3. Kontrollimi i veturave “Kia FA” me nr. regjistrimit *numri i targës...* në të cilën nën ulësen e parë të pasagjerit janë gjetur 2 fishekë evidentuar me nr. 4 dhe një pistoletë evidentuar me nr, 5, numri serik “ V 730691” dhe vetura “VW”, me targa të regjistrimit *numri i targës..* ku në bagazhin e veturës është gjetur një pushkë gjysme automatike pa fishek evidentuar me nr. 7;

-është bërë shikimi në fotoalbum në shtëpinë e të akuzuarit B. P. ku në dhomën e gjumit, në orendive në dhomën, në një sirtar është gjetur një pistoletë, evidentuar me nr. 1 B , një karikator dhe 8 fishekë ;

-është bërë leximi i transkriptit bisedave telefonike në mesë S. dhe E. të datës 10.07.2014, N. K. dhe S. të datës 11.07.2014 dhe E. Th. dhe S. K. të datës 12.07.2014;

-është bërë dëgjimi i CD-eve dhe leximi i transkriptit të bisedave duke zbatuar masat e fshehta të datës 10.07.2014, në ora 10.02.-14: 48, në mesë të E. Th. dhe S. K., në të cilën bisedë përmendet shuma e parave 150, ku i akuzuari E. Th. në bisedë të dëmtuarin e thërret gënjeshtar, bisedojnë për një person i cili gjoja duhet të blejë shtëpinë, përmendet nga Zvicra, Belgjik, Danimark, vlera e shtëpisë ritet në 200.000 €, duke përmendur se kjo vlerë është vlera e borxheve dhe kur S. e pyet “se di qysh u rit ai 200.000 E. përgjigjet “vete djalin tënd kah ka hi borxheve, llugave se me marr ukalaj pare, merr merr merr , po duhet me menu mi la”. Në vazhdim E. bisedon me I. duke i thanë “ ti je tu lujt me zjarrin nja, gruja jote dhe babai yt atë ditë më thanë të ejten , ti um tha të ejtën po kryhet , shka u tash puna , a je tu e dit more se në shpinë teme sun jam tu nejtë oj lop, në shpi teme sun jam tuj mujt me nejt si njeri , tuj um thirr herr njani her tjetri , dhe kur I. mundon me spjegu që duhet me duru edhe pak, edhe një natë E. thot “ e me ba nesër mos ma ardh I. çka bahet, qysh po ti qon ai maret ty pa ba kontratë te noteri pa kurgjo , pastaj të dy të dëmtuarit tentojnë ta bind E. se përmes bankës ka me ardh paret krejt prej bletsit të shtëpisë vazhdon biseda ku E. përmendet letra nga psikologu, noteri, duke i thanë I. “po ajo nata vjen nesër , me bam mas mi ma rune nesër paret , a di çka të baj, maje men, kam e dur me ti thy, mos u ban majmun”, “ se sherin ma shifni, po ju kallzoi, kam hi në burg fer për kurgju, e për juve hi tuj kesh, edhe kur dal masanej, ma zi ja u ba, mos u ban majmun”, bisedën vazhdon me S. ku E. thot “ o kush fol me juve është budall si une, budall si unë ki rras qitu veç maje mend se ki me pagu me krye...”, kur S. sqaron se deri me tretin gusht është veç ipoteka E. përgjigjet “ o ti me tretin gusht, dej me tretin gusht ose unë kam me prit në burg ose ti ki me pjell paret maje mend “,

në vazhdimisht E. tregon se “ a more vesh ma teper mos u mban nervoz ...” , “o ti je mut njeri, a di shka u muti...”dhe kur I. dhe S. premtan që ta sigurojnë para E. thot “ shkrujma letrën, letrën shkruama, që ku e ki, qe fakturën të rrymës “ duke kërkuar ka than “ ja shkruajsh se ki mi pjell sot paret, shkruaj se nesër ki mi mi dhan, se un sjam tu lyp paret, nesër shkruaj, ja ja ato pordha leje ...” dhe vazhdon “ në shpi teme sun jam tu nejt mir etj, ta mar shpirtin ty dhe djalit tand...”, “ kape letrën shkruaje, nesër me mi dhan paret, edhe mos me mi dhan mos mu pritin qetu asnjani, merni kuferat dilni përjasht vet, a u murem vesh, jo koqe mem lujt as ti as baba jut, asnjani”, duke drejtuar S. thotë “S. mos fol se në dor ki me met sot, jam ka te kallztoj, në dor ki me met, gjakin ma ke rit”, “ vazhdon biseda me të dëmtuarin I. ku thot se “ o guxojshe more me mi hangër ti , se ta ha shpirtin “, “shkruje, në qof se si jap në qikaq sahati, shkruje deji në katër e kam afatin, unë jam tuj garantu bashk me babën tem se këna me ja dhan , deri në ora katër ne dy ti mëri, deri në katër mos mi jepni nesër, ju kallztoj un aa”, “I. sha jam te kallztoj, mamir jam ka kallztoj kështu, nga mire ashiqare, nise jam ka të kallztoj, jam ka të lutna kështu si njeri, mos um qo në burg me mu rit qaj thmi pa babë, edhe mos e len thmijën tan pa babë se ti në vorë shkon, jo në burg, ti edhe ti, maj mend, kur tum prishni në krye se dini qka bani,” “koqe mos um luni, po ju kallztoj të dyve baba e bir “,

-është lexuar transkripti i bisedave telefonike të datës 03.07.2014, në mesë të dëmtuarve dhe të akuzuarit N. K. ku në mesë tjerash konstaton se i akuzuari N. K. kërkon të holla në shumë prej 1.500 € për vete dhe shpjegon S. se 40.000 € ja ki ktina,, duke menduar në Gj..

Në bazë të provave të administruara gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I dëmtuari S. dhe i biri i tij I. jetojnë në një shtëpi familjare që gjendet në rr. ...në Prizren, merren me prodhimin e mobileve në punëtorin e tyre “I.” e cila gjendet në kuadër të shtëpisë. Në vitin 2010 i dëmtuari I. pa dijen e babait nga fqinji P. M. ka marrë hua shumë prej 2.000 €, me arsyetim se këto para i duhen për mjekimin e vajzës së tij 2 vjeçare jashtë Kosovës. Meqë nga dita e marrjes së kësaj shume kanë kaluar tre deri katër muaj, kur është dashur t’ia kthente huan, i akuzuari P. ka kërkuar të holla në emër të interesit prej 15 %, siç ka qenë e shënuar në bllokun e të dëmtuarit edhe atë në mënyrë që në fillim ka kërkuar shumat më të vogla prej 100 deri 200 € në muaj e pastaj, me kalimin e kohës shuma e interesit është rritur deri në 700 deri 900 € në muaj. I dëmtuari I. ka tentuar të përgjigjet detyrimin ndaj të akuzuarit P. M., mirëpo meqë kjo ishte pa sukses ai i është drejtuar për ndihmë të akuzuarit E. Th., të cilin e ka njohur prej fëmijërisë sepse banon në lagjen P., afër vendbanimit të tij, duke i treguar se në çfarë shtate gjendet dhe i akuzuari E. i ka ofruar disa vetura të cilat i dëmtuari i ka pranuar në një periudhë të shkurtër kohore, me obligim që t’ia paguajë pas një kohe. Pas skadimit të disa muajve i akuzuari E. ka shkuar shpesh në punëtorin e të dëmtuarit vet por edhe në shumë raste me të akuzuarin A. K.. Në ndërkohë përveç që i dëmtuari ka marrë hua prej të akuzuarve P. M. dhe E. Th., ai ka blerë një automjet “Mercedes” edhe prej të akuzuarit A. K. për shumë prej 2.500 €, ka marr hua prej të akuzuarit B. P. në shumë prej 5.000 €, prej të akuzuarit N. K. shumë prej 2.500 € me interes prej 20 %. Të akuzuarit E. Th., A. K., B. P. dhe N. K. deri diku kanë qenë të njoftuar me situatën në të cilën ka qenë i dëmtuari I. dhe ata e kanë shfrytëzuar atë situatë të pavolitshme të tij, prandaj kanë krijuar një skemë të vizitave të shpeshta në punëtorin e të dëmtuarit të cilat kanë ngjarë në një rastësi të takimeve të tyre aty me qëllim për ti kërkuar borxhet. Kështu, i akuzuari A. K. dhe E. Th. dy herë shkojnë tek i dëmtuari, ku hasin edhe në të akuzuarin B. P. dhe në prezencën e tij me një rast lejnë në tavolinë shumë prej 20.000 € por në momentin tjetër ato para i dorëzojnë të akuzuarit B., ndërsa gjatë vizitës tjetër një javë më vonë ata i dërgojnë 25.000 € të tjera dhe në të njëjtën mënyrë e lejnë në tavolinë por menjëherë pastaj ato para ia dorëzojnë të akuzuarit B. i cili edhe këtë herë ka qenë prezent në

punëtori, e gjithë kjo me arsytim se ata të dytë marrin për sipër obligimet e të dëmtuarit I. ndaj një personi në Pejë dhe ndaj një personit tjetër në Gjakovë. Në fakt i dëmtuari I. ndaj këtyre personave në Gjakovë dhe Pejë as që ka pasur ndonjë detyrim. Duke krijuar një situatë të këtitillë i akuzuari E. Th. dhe A. K. gjatë vizitave të shpeshta në punëtori, tentojnë ta bindin të dëmtuarit se borxhi ka arritur shumë prej 150.000 € ashtu që shkojnë në punëtorin e tyre dhe duke u kërcënuar i bindin që të pranojnë se gjatë muajit shkurt të vitit 2014 kanë marrë tri herë nga 50.000 €, dhe kështu i detyrojnë të nënshkruajnë marrëveshjen lidhur me këtë, por me kusht që nëse nuk paguajnë këtë shumë deri më datën 25.04.2014 në emër të borxhit, shtëpia e tyre do të bartet në emrin e të akuzuarit E. Th., por pasi të lirohet nga hipoteka . Ata u janë kërcënuar se do t'i vrasin të gjithë, se do t'ia vrasin fëmijën në djep, prandaj të dëmtuarit nën këto kërcënime edhe kanë nënshkruar marrëveshjen. Po ashtu është vërtetuar se gjatë bastisjes me datën 14.07.2014 në shtëpinë e të akuzuarit B. P., në katin e parë në dhomën e fjetjes është gjetur një pistoletë ndërsa në dy automjete të të akuzuarit E. Th., të cilat kanë qenë të parkuara afër shtëpisë së tij, janë gjetur një pistoletë dhe një pushkë gjysmë automatike. Është vërtetuar se i akuzuari B. P. me qëllim që vetes t'i sigurojë dobi të kundërligjshme ligjore joproporcionale të dëmtuarit B. M. me datën 10.12.2012 ka huazuar 1.150 €, ka hartuar një procesverbal se kinse i dëmtuari ka pranuar 4.000 € ndërsa pas katër muajve e detyron të njëjtin që t'ia paguajë shumë prej 4.400 €.

Këtë gjendje faktike gjykata ka vërtetuar pjesërisht në bazë të mbrojtjes së të akuzuarve, deklaratave të të dëmtuarve I. e S. K. dhe B. M. dhe provave materiale si procesverbali mbi bastisjen e banesave të të akuzuarit dhe personave, i datës 14.07.2014, lista e dëshmimeve, lista e armëve të konfiskuara, marrëveshja, raporti i ekspertimit të dorëshkrimeve, fotodokumentacioni dhe letrat e fotokopjuara në të cilat janë konstatimet lidhur me huatë të marra nga i dëmtuari dhe konstatimi me shumë të cilën ka pasur për të paguar.

Gjykata ka analizuar mbrojtjet e të akuzuarve dhe ka konstatuar se ato janë të drejtuara në shmangijen nga përgjegjësia penale. Në fakt nuk është kontestuese se shtëpia e të akuzuarit P. M. gjendet në një largësi prej 200 metra nga shtëpia e të dëmtuarve, se i akuzuari P. merret me blegtari, se disa herë ka shkuar në punëtorin e të dëmtuarve dhe ka marrë byk për nevojat e punës, se një herë i dëmtuari S. prej tij ka blerë një dash për festën e Kurban Bajramit, se për këtë ka paguar 2 - 3 ditë më vonë si dhe se raportet në mes tyre kanë qenë të mira si komshi. Kjo pjesë e mbrojtjes së të akuzuarit mbështetet edhe me deklaratat e të dëmtuarve I. dhe S. K.. Mirëpo gjykata nuk ka pranuar pjesën e mbrojtjes së të akuzuarit Palë se shumë prej 2.000 € prej tij ka huazuar i dëmtuari S., sepse nuk ka mbështetje në provat. I dëmtuari S. K. në mes tjerash ka dëshmuar se asnjëherë prej të akuzuarit P. M. nuk ka marrë hua, nuk ka ditur se djali i tij I. ka huazuar të holla të cilën gjë ka kuptuar kur I. i ka pohuar se ka marrë të holla dhe kur i akuzuari P. ka ardhur në punëtorin e tyre dhe ka kërkuar të holla, kur me një rast i ka dhanë 3.000 € e pas disa ditësh edhe 2.300 €. I kujtohet vetëm rasti kur prej të akuzuarit P. ka blerë një dash për festën e Kurban Bajramit dhe ka paguar pas 2 – 3 dite, ndërsa i dëmtuari I. ka dëshmuar se prej të akuzuarit P. M. ka kërkuar hua prej 2.000 €, kur ka pasur nevojë për shërimin e vajzës jashtë Kosovës dhe se pas kalimit të 3 – 4 muajve i akuzuari ka kërkuar të hollat, në fillim ka kërkuar 100 – 200 € në emër të interesit ndërsa më vonë edhe 700 – 900 €.

Po ashtu gjykata nuk ka pranuar mbrojtjen e të akuzuarit E. Th. se në periudhën kohore prej muajit tetor 2013 e deri në prill 2014, së pari i ka dhanë I. dy vetura e më vonë të dëmtuarit S. K. i ka dhënë 11 automjete dhe një shvajcë aparat, të gjitha në vlerë prej 53.000 €, se pas një kohe të shkurtër me telefon e ka ftuar i dëmtuari S. dhe ka kërkuar një shumë më të lartë të hollave, se të hollat nuk i ka pasur prandaj ka dhanë vetura “Kia” dhe “Korado” dhe meqë ka qenë i interesuar për të blerë shtëpinë e tij disa herë i ka dhanë para ashtu që

borxhi i përgjithshme ka qenë 150.000 €, prandaj i dëmtuari I. ka përgatitur një marrëveshje në të cilën ka pasur vërejtje sepse në atë marrëveshje nuk ishin të shënuara vlerat e veturave të cilat i ka dhanë e as shumat e sakta të cilat i ka dhanë, se asnjëherë nuk ka bërë presion dhe kërcënime që i dëmtuari ta bartë shtëpinë në emrin e tij por kur S. e ka rritur çmimin e shtëpisë edhe për 80.000 € ai nuk ka pasur mundësi të paguaj shtëpinë. Mbrojtja e të akuzuarit është në kundërshtim me deklaratat e të dëmtuarve dhe me provat materiale. Në fakt, i dëmtuari I. ka dëshmuar se deri sa ende ka pasur borxh P. M., me telefon ka ftuar të akuzuarin E. Th., të cilin e ka njohur prej femijërisë se jeton në lagjen ... afër shtëpisë së tyre, E. Th. i ka ofruar që nga ai të merr automjete të ndryshme në afate të volitshme për t'i zvogëluar borxhet që ka pasur ndaj njerëzve, ashtu që nga E. Th. gjatë pjesës së dytë të vitit 2012 deri në muajin gusht të vitit 2013, ka marrë 7 automjete edhe atë "Citroen Berlingo", për 3.500 €, "BMV" 316 për 2.500 €, "Ford Eskord" për 800 €, "Fiat Uno" për 1.000 €, "Opel Kalibër" për 1.200 €, një kombi T3 për 1.700€ dhe një të tipit "BMV" për 1.800 € dhe janë marrë vesh që pagesa të fillojë pas 3 muajve sipas mundësisë. Meqenëse diku në shkurt të vitit 2014 në punëtori është paraqitur i akuzuari B. P. dhe ka kërkuar borxh prej 68.000 € dhe ka prezantuar një letër se kinse e ka marrë këto para, me telefon ka ftuar E. Th. i cili ka ardhur në lokal dhe pasi që kanë përfunduar bisedën në mes vete E. i ka thanë babës se mund të marr përsipër borxhin të cilën e kërkonte B. P. ashtu që të njëjtën ditë E. i ka sjellë babës 7.500 € dhe një automjet të tipit "Bora" të cilën e ka llogaritur 8.000 €, pas dhjetë dite E. së bashku me A. K. kanë sjellë 20.000 € të cilit menjëherë i ka dhanë B. dhe pas disa dite kanë sjellë edhe 25.000 € të cilat po ashtu i ka marrë B. dhe atëherë E. i ka treguar se B. i kanë dhënë para në emër të borxhit që kërkon prej tij dhe një "C klasë" me targa të Gjilanit të cilën e ka llogaritur në vlerë prej 10.000 € dhe pasi ka kaluar muaji mars deri sa ai ka qenë në qytet, në punëtori ka ardhur E. Th. dhe prej babës ka kërkuar borxh prej 107.000 €, kur i kanë thanë se nuk ka para, është paraqitur pas një muaj dhe i ka thanë se tani borxhi është 118.000 € dhe të nesërmen deri sa ka qenë në qytet ka ardhur së bashku me A. K. me një kontratë se kinse ata nga babai kanë blerë shtëpinë për 150.000 € dhe se çmimin e kanë paguar tri herë nga 50.000 € dhe pasi janë kërcënuar babait se do t'i vrasin si ata ashtu edhe fëmijën e vogël nëse nuk e nënshkruan kontratën për shitblerjen e shtëpisë, andaj babai nga frika ka nënshkruar dhe në momentin kur ka mbritur në punëtori babai i ka thënë që duhet të nënshkruajë, ashtu që një kopje e kanë lënë në punëtori dhe dy i kanë marrë. Në atë drejtim ka dëshmuar edhe i dëmtuari S. K. i cili në mes tjerash ka sqaruar se prej të akuzuarve nuk ka marr asnjë para por i ka dhënë. I kujtohet se të akuzuarit E. dhe A. prej shkurtit 2014, kanë ardhur shpeshë në shtëpi e tyre, çdo të dytën ditë e ndonjëherë edhe dy herë në ditë. Ka ndodhur që kanë sjellë të holla, një herë 20.000 € dhe dytën herë 25.000 €, por aty për aty ia kanë dhënë B. kur A. ka thanë se këto para janë për të mbuluar borxhet e I. personave në Gjakovë dhe në Pejë, dhe të dytë u janë kërcënuar që të pranojnë këto borxhe me fjalë " kemi me ta marrë djalin e shtimë në gepek, ja nxjerrim sytë, ja nxjerrim bybreg, se në varrë do ta kruan kokën ". Nuk i kujtohet data, diku në muajin maj kur kanë ardhur në shtëpi E. ka pasur në dorë disa letra dhe deri sa A. ka qëndruar anash E. i ka thanë se në emër të borxheve që ka paguar për djalin e tij I., për automjete dhe kamat, borxhi është rritur deri në shumë prej 150.000 €, duke kërkuar që të nënshkruajnë marrëveshjen e cila ka qenë i përpiluar në gjuhën shqipe, të cilën nuk e ka kuptuar por nga presioni ka nënshkruar. Pas kësaj E. shpesh ka ardhur, ka pyetur se a kanë gjetur blerësin e shtëpisë, po ashtu ka bërë presion që shtëpia të shpallet në shitje duke i thënë " do të më nxjerr me forcë nga shtëpia". Në atë drejtim flasin edhe provat materiale, transkripti i bisedave telefonike në mes të akuzuarit E. Th. dhe të dëmtuarve I. dhe S. K. ku përmendet shuma e parave 150.000 €, vlera e shtëpisë 200.000 € dhe fjalët kërcënuese "ti je tu lutj me zjarrin , a di çka të bëj, maje mend, kam hi në burg për kurgjo e për juve hi tuj kesh edhe kur dal masanej ma zi ja u baj, se ke me pagu me krye", duke i bërë presion i detyron që të shkruajnë letër duke e kërcënuar "S. mos fol se në dorë ki me met sot gjakun ma ke rit ju kallxoj unë"...etj.

Gjykata po ashtu nuk ka pranuar mbrojtjen e të akuzuarit A. K., se nuk u është kërcënuar ndaj të dëmtuarëve, po disa herë ka qenë në vizitë në punëtorin e tyre për të kërkuar boxhin në emër të automjetit të shitur, të markës “Mercedes”. Kjo sepse të dëmtuarit gjatë dhënies së dëshmisë kanë deklaruar se A. çdo herë ka ardhur me E. Th. dhe me ato raste në mënyrë të drejtpërdrejtë është kërcënuar duke u thënë se do ti vrasin, se do të ja vrasin fëmijët në djep, se vajzën do dërgojnë nëpër lokale të ndryshme për të punuar si prostitute etj.

Gjykata nuk ka pranuar mbrojtjen e të akuzuarit N. K. në atë drejtim se asnjëherë nuk i ka dhanë asgjë hua e as që ka i shitur diqka I. ndërsa babait të tij S. i ka dhanë 2.000 € hua. kjo sepse në atë drejtim I. ka dëshmuar se gjatë muajit mars të vitit 2014 ka pasur nevojë që djali i tij 6 muajsh të operohet në Prishtinë dhe prandaj prej B. ka kërkuar 800 € por pasi që B. ka refuzuar dhe i ka thanë se mund të njoftojë me N. K.. Pas takimit me N., ky i ka thënë se nuk mund t’i japë 800 € por 2.500 € me kamatën mujore prej 20%, e si garanci ka kërkuar që automjeti i tipit “Golf 4” të bartët në emër të tij, e në emër të shumës prej 2.500 € pas një kohe ka kërkuar 6.700 €. Në atë drejtim ka dëshmuar dëshmitari S. K. i cili në mes tjerash ka deklaruar se në muajin mars të vitit 2014 në punëtori ka ardhur N. K. dhe ka kërkuar 6.700 € se kinse këto të holla nga ai ka marr I. dhe kur ka pyetur I., ai ka pohuar këtë, ndërsa ai nuk ka marrë hua nga ky i akuzuar.

Gjykata ka pranuar mbrojtjen e të akuzuarit B. P. në atë pjesë se një veturë e tipit “Audi A 4”, pronë e vëllait të tij N. P. i cili jeton në Suedi, ka qenë tema e bisedës me të dëmtuarin I. kur janë marrë vesh edhe për çmimin prej 8.000 €. Kjo sepse i dëmtuari I. ka dëshmuar se diku në muajin dhjetor 2013 B. e ka njoftuar me vëllain e vetë N., ky i cili ka propozuar që I. të blejë veturë për çmim prej 8.000 € dhe janë marr veshë për pagesën gjatë muajit .

Mirëpo gjykata nuk ka pranuar pjesën e mbrojtjes se të akuzuarit B. P. se të dëmtuarit I. i ka dhanë shumën prej 10.000 € në prezencën e babait të tij, me marrëveshje që do ta kthejë pas shitjes së shtëpisë. Kjo sepse i dëmtuari ka dëshmuar se në vitin 2013 ka huazuar prej B. 5.000 €, me kamat prej 20 % dhe në muajin shkurt të vitit 2014 babai i tij ka kthyer borxhin në mënyrë që kanë shkuar në shtëpinë e të akuzuarit B. dhe 7.000 € i ka dhanë bashkëshortes në dorë. Lidhur me këtë ka dëshmuar edhe i dëmtuari S. i cili në mes tjerash ka shpjeguar se të akuzuarin B. më herët nuk e ka njohur deri atë ditë kur i akuzuari ka ardhur në punëtori dhe ka biseduar me I. i cili ka thanë se B. kërkon 7.000 € dhe se duhet t’ia japë këto para deri në ora 23:00, e nëse nuk i dorëzojnë do të kenë probleme, ashtu që së bashku me I. kanë shkuar dhe 7.000 € ia kanë dorëzuar bashkshortes e të akuzuarit, siç i ka porositur vet B. me telefon.

Gjykata po ashtu nuk ka pranuar mbrojtjen e të akuzuarit B. se prej të dëmtuarit B. M. ka blerë një kamion dhe se një pjesë e çmimit ka paguar menjëherë ndërsa pjesën tjetër pasi kanë rregulluar dokumentacionin. Kjo sepse i dëmtuari B. M. ka dëshmuar se të akuzuarin B. e ka njohur në vitin 2012, deri sa ka punuar në pompën e benzinës “E. V.” në K. ku me një rast i akuzuari B. ka blerë naftë dhe ka filluar bisedën duke i thanë që nëse ndonjëherë ka nevojë për para mund t’i paraqitet atij duke ia dhënë edhe numrin e telefonit. Kështu diku në fillim të muajit dhjetor të vitit 2012, me të vërtet ka pasur nevojë për shkak të disa obligimeve në familje, andaj me telefon e ka ftuar B. dhe ka kërkuar 600 € por B. i ka thanë se nuk mund t’i japë më pak se 1.000 €, ashtu që ia ka dhanë 1.150 €, prej të cilave menjëherë i ka mbajtur 350 €, ka marrë letërnjoftimin e tij, ka bërë fotokopjone saj dhe në atë fotokopje ka shënuar tekstin “ unë B. M. i mora prej N. P., me datën 10.11.2012 , 4.000 €”, ka shënuar edhe numrin e tij të telefonit, e ka nënshkruar deklaratën edhe pse nuk i ka marrë 4.000 €, N. P. në ato momente nuk ka qenë prezentë. Pas katër muajve axha e tij H. M. i ka kthyer 4.400 € .

Gjykata nuk ka pranuar tezën e mbrojtësit të të akuzuarit P. M. se në veprimet e tij ekzistojnë elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, sepse i akuzuari P. ka dhënë hua të dëmtuarit S. në shumë prej 2000 euro, të cilat i dëmtuari ia ka dhënë P. M., në fakt janë të hollat të cilat kanë qenë të destinuara për M. R., në emër të automjetit të cilin i dëmtuari I. e ka blerë prej tij, në të cilin raport i akuzuari P. M. ka qenë vetëm ndërmjetësues vetëm për arsye që ti ndihmonte S. për zgjatjen e afatit të pagesës. Kjo sepse kjo tezë e mbrojtjes nuk ka mbështetje në asnjë provë të administruar dhe lidhur me faktin se i dëmtuari S. ka paguar të hollat, ka dëshmuar ai vet, ndërsa ka mohuar se ka huazuar ndonjëherë para nga i akuzuari P. M..

Gjithashtu nuk pranohet teza e mbrojtjeve të të akuzuarve E. Th. dhe A. K. se në veprimet e tyre nuk formohen elementet e veprës penale për të cilën janë akuzuar sepse nuk ekziston dashja si element subjektiv i veprës për të realizuar qëllimin e përfitimit të të kundërligjshëm të dobisë pasurore me përdorimin e forcës apo kanosjes. Kjo sepse nga tërë zhvillimi i ngjarjes del se në rendin e parë ata që shërbejnë mohimit të provave nga akuzat, gjykata i nxjerr provat mbi raportin psikik të kryesve ndaj veprimeve të tyre dhe ndaj pasojave dhe nxjerr konkluzion se të akuzuarit kanë vepruar me një qëllim të caktuar, në rastin konkret me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, ashtu që për të realizuar këtë qëllim ata kanë përdorur kërcënim serioz ndaj të dëmtuarve, për veç tjerash “se do ti vrasim të gjithë, se do ta vrasim fëmijën në djep, se me dhunë do ti dëbojnë nga shtëpia etj”, me ç’rast gjatë një bisedeje me të dëmtuarin i akuzuari E. ia ka treguar revolen duke i thënë që nuk shkon askund pa revole.

Pra, gjykata konsideron se në veprimet e tyre formohen elementet e veprave penale, duke marrë parasysh se vepra penale është e kryer atëherë kur është përdorur dhuna, apo kërcënim serioz, për ta detyruar personin që të veprojë ose të mos veprojë në dëm të pasurisë së tij apo tjetrit, dhe për të ekzistuar vepra nuk është e domosdoshme që kryesi i saj me veprimin e bërë të përfitojë dobi të kundërligjshme për vete apo për personin tjetër.

Gjykata ka besuar deklaratave të dëmtuarve S. K. dhe I. K., sepse janë të bindshme, ata janë persona që në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë përjetuar të gjitha situata e përmendura, të cilat kanë ndikuar vetëm në ata por edhe në të gjithë anëtarët e familjes së tyre, deklaratat e të cilëve na udhëzojnë të vërtetën e ngjarjeve të ndodhura dhe janë të mbështetura me provat materiale. Po ashtu duke marrë parasysh edhe natyrën e këtyre veprave penale të cilat lëjnë ose nuk lëjnë gjurmë, por në anën tjetër duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, si në rastin konkret, gjykata konstaton se në veprimet e të akuzuarve P. M., E. Th., A. K., B. P. dhe N. K. janë formuar të gjithë elementet e veprave penale për të cilat janë shpallur fajtorë dhe dënuar sipas ligjit.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka analizuar provat e administruara dhe ka konstatuar se i akuzuari N. K. ka shkuar në punëtorinë e të dëmtuarve dhe përmes telefonit ka bisduar me ta, ka shkuar vetë dhe me djalin e N. P. për të kërkuar shumën e parave prej 41.000 euro, dhe i ka thënë se nëse nuk i paguajnë borxhin në atë shumë do të rritet kamata. Këto fakte gjykata ka vërtetuar në bazë të deklaratës së të dëmtuarit I. i cili në mes tjerash ka dëshmuar se N. ka ardhur në punëtori dhe ka kërkuar shumën prej 41.300 euro, parat nuk kanë qenë të tij, por të N. P.. I dëmtuari S. ka dëshmuar se në fillim të muajit korrik në lokalit të tij ka ardhur N. K. dhe nga ai ka kërkuar 42.000 euro, kinse për borxhin të cilin ia kishte djali i tij, nuk ka pasur mundësi për t’ia dhënë të hollat, N. nuk e ka kërcënuar, po vetëm i ka thënë se kamata rritet.

Gjykata ka besuar në dëshminë e të dëmtuarve pasi që të njëjtat janë në harmoni dhe në mbështetje me provat materiale- transkriptet e bisedave telefonike në mes të dëmtuarve me të akuzuarin N. K. dhe personin me emrin Gj., ku i akuzuari N. thotë “për me mëshu shkurt, nesër katërdhjetëmijë ja ki ktina, një mijë e pesqind mua, pesqind mi ka hek gruja e këtina”.

Po ashtu nuk është kontestuese se i akuzuari E. jeton në shtëpi në të njëjtën lagje me të dëmtuarit një kohë të gjatë, se me ta kanë pasur raporte të mira, se ka ditur se babai i tij ka huazuar të dëmtuarit I. 2000 euro, ka biseduar me të dëmtuarin I. në emër të kamatës duke i thënë se duhet të paguaj “zbon ashtu”. Këto fakte gjykata ka vërtetuar në bazë të deklaratave të të dëmtuarve, ku i dëmtuari I. ka spjeguar se prej të akuzuarit E. nuk ka huazuar para, se E. disa herë ka ardhur në punëtori dhe i ka thënë se duhet t’ia paguaj borxhin të cilin e ka marrë prej babës, se nuk bënë kështu dhe duhet ta paguajë patjetër duke ia kërkuar nga 200, 300 euro, mirpëpo nuk ka bërë presion në mënyrë tjetër, meqë janë kojshi kanë biseduar normal dhe pasi ka shkuar E., nuk ka ndier frikë por i vitnte keq që nuk ka pasur mundësi të paguajë. Deklerata e dëshmitarit I. mbështet dhe është në përputhje edhe me deklaratën e të dëmtuarit S., i cili ka dëshmuar se E. e njeh, ai është djali i P. M., me të jetojnë në të njëjtën rrugë dhe e di se shpesh ka ardhur në punëtorin dhe ka kërkuar byk për kafshë. E. nuk e ka kërcënuar.

Duke pasur parasysh se të dëmtuarit kanë thënë se të akuzuarit N. K. dhe E. M. nuk u janë kërcënuar, nuk kanë përdorur asnjë dhunë po vetëm kanë kërkuar të hollat, se i akuzuari E. u ka thënë se duhet të paguajnë para, ndërsa i akuzuari N. K. u ka thënë se nëse nuk paguajnë do të rritet kamata, pra sipas mendimit të gjykatës në veprimet e tyre nuk formohen elementet e veprës penale të detyrimit, sepse për të ekzistua kjo vepër penale është e domosdoshme që me anë të përdorimit të forcës dhe të kërcënimit të detyrohet personi që të veproj ose të mos veproj në dëm të pasurisë së tij apo të personit tjetër, prandaj gjykata i ka liruar nga akuza në mungesë të provave.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese ku prej rrethanave rënduese për të akuzuarin P. M. ka marrë parasysh se ka shfrytëzuar raportet e afërta fqinjësore me të dëmtuarin I. i cili nuk ka pritur që fqinji i tij do të shfrytëzon situatën në të cilën është gjetur, për të akuzuarit E. Th. dhe A. K. mënyrën e kryerjes së veprës penale duke pasur parasysh se me veprimet e tyre kanë shkuar aq largë sa që i kanë rrezikuar të mbesin pa shtëpi, gjë që edhe kanë përmendur kur e kanë detyruar të gjente blerësin e shtëpisë duke caktuar edhe çmimet e shitjes, për të akuzuarit B. P. dhe N. K. se kanë shfrytëzuar gjendjen në të cilën janë gjetur të dëmtuarit duke ditur lojën tashmë të servuar nga ana e të akuzuarve të tjerë, ndërsa prej rrethanave lehtësuese për të gjithë të akuzuarit gjykata ka marrë parasysh se janë familjarë dhe sjelljet korrekte gjatë gjithë procedurës, prandaj i ka shpallur fajtorë dhe ka dënuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke pritur se edhe me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 450 të KPP-së.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të nenit 69 të KP-së.

Vendimi mbi kërkesën pronësore juridike është marrë në bazë të nenit 463 të KPP-së.

Nga të cekurta më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.31/2015 të datës 16.01.2018

**Sekretarja juridike
Valdete Zurnaxhiu**

**Kryetari i trupit gjykues
Raima Elezi**

KËSHILLA JURIDIKË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.